

SEMESTRI I PARË

FIKH 1



Hyrje në lëminë e Fikhut:

Përkufizimi i Fikhut

Përkufizimi gjuhësor: "Fikh" (الفقه) do të thotë *njohje, kuptim*.

Me të njëjtën domethënie është përdorur edhe në ajetin ku Musai alejhi selam me lutje i drejtohet Allahut të Lartësuar:

وَاخْلُلْ عُقْدَةً مِّن لِّسَانِي يَفْقَهُوا قَوْلِي

“Dhe zgjidhja nyjën nga gjuha që ata ta kuptojnë fjalën time.”¹

Përkufizimi terminologjik: *Njohja e dispozitave të Sheriatit që ndërlidhen me veprat (e njeriut) dhe me argumentet e tyre të hollësishme.*

Sqarim i përkufizimit

Me fjalën **“njohja”** është për qëllim dija e sigurt dhe ajo e mundshme me probabilitet më të madh të saktësisë, e jo dija e pambështetur, supozuese.

Ndërsa me pjesën **“dispozitat e Sheriatit”** janë për qëllim dispozitat e përfituara nga Sheriati, si p.sh. njohja se një praktikë e caktuar është vaxhib ose haram. Këtu përjashtohen njohuritë e përfituara nga logjika si dhe njohuritë e përfituara nga përvoja.

Ndërsa me fjalinë **“që ndërlidhen me veprat (e njeriut)”** janë për qëllim ato gjëra që nuk lidhen direkt me bindjen dhe besimin (akiden), si kryerja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi, etj..

Andaj, në përkufizimin e fikhut përjashtohen ato gjëra që lidhen me besimin, si teuhidi (njësimi) i Allahut dhe njohja e Emrave dhe Atributeve të Tij. Pra këto nuk përfshihen në “fikh”, sipas kuptimit terminologjik të tij.

Ndërsa me pjesën **“me argumentet e tyre të hollësishme”** janë për qëllim argumentet e zbërthyera, të imtësuar, nga të cilat nxirren dispozitat e fikhut. Kështu që përjashtohet nga ky përkufizim shkenca e Usuli Fikhut, për shkak se ajo studion argumentet e përgjithshme të fikhut.

¹ Ta-Ha: 27, 28

Ndarja e Fikhut

Më lartë qartësuam se Fikhu është shkencë e cila studion ligjet praktike islame, të cilat burojnë nga shpallja që i kanë zbritur të Dërguarit ﷺ.

Dijetarët, kur shkruajnë rreth kësaj shkençe në librat e tyre, dallojnë në mënyrën se si e bëjnë ndarjen e tematikave që shtjellohen aty.

Më e përgjithshme është që ndarja të bëhet në dy pjesë:

Kismul Ibadat (قسم العبادات) - Pjesa e adhurimeve,

Kismul Muamelat (قسم المعاملات) - Pjesa rreth normave ndërnjerëzore – (kodi i së drejtës qytetare është një prej sektorëve të kësaj pjese të Fikhut).

Burimet e Fikhut

Me burimet e fikhut kemi për qëllim argumentet apo referencat në të cilat mbështetet Sheriati dhe nga të cilat nxirren dispozitat islame. Ato janë:

1. Kurani
2. Suneti
3. Ixhmaja¹ për një çështje legjitime
4. Kijasi (Analogjia).

Duhet ditur se shumica e dijetarëve janë të pajtimit rreth këtyre katër burimeve, por tek disa prej tyre ka më shumë burime apo referenca të Sheriatit.

¹ Pajtimi i muxhtehidëve të një kohe nga populli i Muhamedit ﷺ, ky është një prej përkufizimeve të njohura të Ixhmasë.

Metodologjia jonë në mësimin e Fikhut

Prej gjërave me të cilat karakterizohet ky program është se këtu përmenden vetëm meseletë (çështjet) për të cilat njerëzit kanë nevojë, duke mos u dhënë shumë rëndësi degëzimeve dhe detajeve të shumta që i kanë këto mesele. Të përmbajturit mendimit që është i bazuar në argument të qartë, mendim që sipas neve është më afër Sunnetit.

Çfarë përfitojmë nga studimi i Fikhut?

Njohja e Fikhut dhe puna me këtë dituri rezulton me përmirësim të njeriut, adhurimeve të tija dhe e bën njeriun një person me nivel të lartë të vetëdijes fetare. Nëse njeriu e përmirëson veten e tij, kjo tregon dhe jep sinjal të mirë se e gjithë shoqëria mundet ta zgjedh këtë rrugë. Ndërsa rezultati final dhe ajo që e shpreson njeriu nga të mësuarit dhe studiuarit këtë lëmi është lumturia dhe lehtësimi i çështjeve fetarë në këtë botë dhe kënaqësia e Allahut në Botën tjetër.

Sqarimi i disa termeve të Fikhut

Mukelef: Quhet personi i cili ngarkohet me zbatimin e dispozitave të Sheriatit. Pra, ai që arrin moshën e pjekurisë dhe është i mençur.

Fekih: Shumës fukaha. Personi i cili është ekspert në jurisprudencën islame, fikh.

Fetva: Opinioni juridik i një fekihu apo i një grupi në lidhje me ndonjë çështje të Sheriatit.

Medh`heb: Drejtim apo shkollë e mendimit; përmbledhja e përgjithshme e vendimeve juridike të një dijetari të madh (imami), gjithashtu edhe nxënësve të tij dhe të gjithë dijetarëve të cilët i përmbahen metodës së tij.

Mesele: Shumës mesa`il. Temë, çështje apo problematikë e fikhut.

Mufti: Dijetari që jep fetva.

Ixhtihad: Përpjekja e fekihut me të gjitha mundësitë për të gjetur dispozitën e Allahut rreth një çështjeje të caktuar përmes burimeve të Sheriatit (Kurani, Suneti, Ixhmaja, etj.).

Muxhtehid: Dijetari i cili është i kualifikuar për të nxjerrë vendime me anë të ixhtihadit.

Ixhma: Pajtimi (unifikimi) i muxhtehidëve të një kohe, nga umeti i Dërguarit ﷺ, për një çështje të Sheriatit.

Mufesir: Komentues i Kuranit.

Muhadith: Dijetar i shkencave të hadithit.

Mukal-lid: Myslimani i rëndomtë i cili pason ndonjë dijetar ose medh`heb pa e kërkuar argumentin.

Taklid: Të ndjekurit e ndonjë opinioni, dijetari apo medh`hebi pa hulumtuar argumentin në të cilin mbështetet.

Kijas: Analogji, apo krahasimi i një çështjeje Sheriatike.

Ulema: njëjës alim, që d.m.th. dijetarë.

Kapitulli [I]: Normat e pastërtisë dhe ujërave (كتاب الطهارة)

Dispozitat e pastërtisë (الطهارة) dhe ujërave:

Rëndësia e pastërtisë dhe llojet e saj:

Namazi vlerësohet si adhurimi më i rëndësishëm me të cilin Allahu i Lartësuar na obligoi pas dy dëshmime (shehadetit).

Për këtë edhe fukahatë, kur i shtjellojnë dispozitat e fikhut, fillojnë me sqarimin e dispozitave që kanë të bëjnë me këtë adhurim mjaft të rëndësishëm. Por pasi që pastërtia është kushti thelbësor për vlefshmërinë e namazit, njëherë ajo llogaritet edhe çelës i tij, ashtu siç thotë i Dërguari ﷺ: "*Çelësi i namazit është pastërtia*"¹.

Pastërtia ndahet në dy lloje:

1. Pastërti shpirtërore-kuptimore (الطهارة المعنوية):

Është pastërtia e zemrës nga shirku, gjynahet dhe nga çdo gjë e cila dëmton zemrën. Ky lloj i pastërtisë është më i rëndësishëm se pastërtia trupore-fizike, andaj nuk ka mundësi që të arrihet pastërtia trupore (e vërtetë) derisa në zemër ka shirk. Allahu i Madhëruar thotë:

إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ الْمَشْرُكُونَ نَجَسٌ

"*Me të vërtetë mushrikët janë nexhis (të ndytë)*"².

2. Pastërti trupore-fizike (الطهارة الحسية):

Ky lloj i pastërtisë do të jetë tema e shtjellimit tonë, inshaAllah.

¹Shënon Tirmidhiu, Ebu Daudi dhe hadithi është hasen.

² Et-Teube: 28

Përkufizimi i pastërtisë – tahare-s:

Përkufizimi gjuhësor: Fjala "tahare" "الطهارة" do të thotë: *pastërti, dëlirësi*.

Përkufizimi terminologjik: *Mënjanimi i hadethit¹ dhe pastrimi i ndyrësirave.*

Shpjegim i përkufizimit:

Mënjanimi hadethit: Mënjanimi i gjendjes apo cilësisë e cila e ndalon njeriun nga namazi, duke përdorur ujë në pastrimin e të gjithë trupit, nëse *hadethi* është *hadeth* i madh, e nëse është *hadeth* i vogël, atëherë lajmë pjesët e avdesit me *nijet*. Shembull: Një njeri ka urinuar, pastaj është pastruar nga urina dhe ka marrë avdes, që d.m.th se pas urinimit nuk lejohej për të që të falet, mirëpo pasi morri avdes e largoi *hadethin*, atëherë në këtë gjendje iu lejua namazi.

Nëse nuk ka ujë apo nuk ka mundësi që të përdor ujë, atëherë përdoret zëvendësuesi i ujit, dhe, në mënyrën që na ka urdhëruar Ligjvënësi. Kjo formë e pastrimit (*tejemmumi*) do të përmendet më vonë.

Vini re: Nga kjo që u tha kuptohet se:

Pastërtia trupore-fizike nënkupton dy çështje:

- a. Mënjanimi-pastrimi i hadethit, është e veçantë për trupin.
- b. Mënjanimi-pastrimi i khabethit (ndyrësisë), e cila ndyrësi mund të jetë në trup, tesha apo vend.

Hadethi ndahet në dy lloje:

- a) *Hadeth i madh:* është lloji i *hadethit* i cili obligon guslin (larjen).
- b) *Hadeth i vogël:* është lloji i *hadethit* i cili obligon avdesin.

Transmetohet nga Ebu Hurejra se ka thënë: I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Allahu nuk e pranon namazin e askujt prej jush, pas hadethit, derisa ai të marrë avdes.*”²

Janë pajtuar dijetarët islam se nuk pranohet namazi pa qenë i pastër nëse njeriu ka mundësi të arrij tek pastërtia.

¹ El-hadeth (الحدث): është gjendje e cila e ndalon njeriun nga namazi apo nga ndonjë adhurim tjetër për kryerjen e së cilit kushtëzohet pastërtia. Hadethi ndahet në dy lloje: i vogël dhe i madh.

²Buhariu (2954), Muslimi (225), Tirmidhiu (76) dhe Ebu Daudi (60).

Ndyrësira (*khabethi*)¹ ndahet në tri lloje:

- a) *Ndyrësirë (papastërta) e cila medoemos të lahet.*
- b) *Ndyrësirë e cila stërpiket.*
- c) *Ndyrësirë e cila fshihet (fërkohet).*

Shtyllat e pastërtisë:

Si çdo vepër, apo çdo adhurim po ashtu edhe pastërtia ka disa elemente, të cilat ne i quajmë shtylla, sende pa të cilat nuk plotësohet kjo vepër. Këto shtylla janë:

- a) *Personi i cili pastrohet*
- b) *Gjëja (lënda) me të cilën pastrohet*
- c) *Procesi i pastrimit*

Për t'u llogaritur pastërtia se është fetare, medoemos që t'i ketë plotësuar këto tre shtylla.

Personi i cili pastrohet: esenca është se pastërtia i obligohet atij personi i cili e ka obligim namazin, andaj dijetarët cilësitë e këtij personi i kanë përmendur në kapitullin e namazit, ngase ky kapitull është bazë.

Ndërsa sa i përket shtyllës së dytë dhe të tretë, themi se këto dy çështje janë tematika e kapitullit tonë për të cilin jemi duke folur. Mirëpo duhet ditur mirë se ne i japim përparësi të folurit për lëndët me të cilat mund të pastrohemi, para se të nisim të flasim për mënyrën e pastrimit, ngase nuk mund të pastrohemi derisa ta dimë se me çfarë mund të pastrohemi.

Cilësitë e ujit:

- a) **Ngjyra**
- b) **Era**
- c) **Shija**

Këto tre cilësi të ujit janë kriteret të cilat i japin ujit emërtimin dhe dispozitën e merituar fetarisht. Nuk ka dallim gjatë ndryshimit të këtyre cilësive a është uji shumë apo pak, d.m.th sasia e ujit nuk është kriter, e as element të cilit i jepet rëndësi gjatë procesit se ndryshimit të një prej këtyre 3 cilësive.

Kur lënda e papastër ndryshon shijen, ngjyrën apo aromën e ujit. Në këtë rast, ky ujë nuk mund të përdoret më për pastrim.

¹ Habethi (الخبث): Është çdo papastërit-ndyrësirë e cila fetarisht duhet pastruar dhe larguar.

Sipas Ibn El Mundhir dhe Ibn El Mulakin në këtë çështje ka Ixhma'a në mesin e dijetarëve .

Llojet e ujit:

1. Ujë Tahuur (طهور)

Uji Tahuur: Është ujë i pastër, i cili ka mbetur në gjendjen e tij të natyrshme dhe që nuk i është ndryshuar shija, era apo ngjyra me diçka të papastër.

Ky lloj i ujit është uji i cili është i pastër në vete dhe ka mundësinë e pastrimit të diçkaje tjetër.

Në këtë lloj uji bëjnë pjesë disa kategori:

a) Uji i shiut, dëborës dhe breshrit: Këto ujëra konsiderohen të pastra në bazë të fjalëve të Allahut:

وَأَنْزَلْنَا مِنَ السَّمَاءِ مَاءً طَهُورًا

“...dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë (Tahuur) të pastër...”¹.

Po ashtu për pastërtinë e këtyre ujërave argument është thënia e të Dërguarit ﷺ: *"O Allah! Më pastro nga mëkatet, ashtu sikurse rrobat e bardha pastrohen nga papastërtitë! O Allah, laji mëkatet e mia me dëborë, shi dhe breshër!"²*

b) Uji i detit: Ebu Hurejra transmeton se një burrë e pyeti të Dërguarin ﷺ: *"O i Dërguar i Allahut! Ne lundrojmë në det dhe marrim me vete vetëm pak ujë. Nëse e përdorim atë për avdes, atëherë nuk do ta shuajmë dot etjen. Pra, a mund të marrim avdes me ujin e detit?" I Dërguari ﷺ iu përgjigj: "Uji i tij (i detit) është Tahuur (i pastër) dhe ngordhësira e tij është e lejuar"³.*

c) Uji i lumenjve: Prej argumenteve se ky ujë është i pastër është thënia e Dërguarit ﷺ: *"Vini re! Po të kishte ndonjëri nga ju lum para derës së tij dhe të pastrohej në të çdo ditë pesë herë, a do t'i mbetej ndonjë ndyrësirë?"⁴*

d) Uji i mbetur (S'uri): Sipas Sheriatit, ky ujë konsiderohet i pastër, pavarësisht nëse në të ka pirë një mysliman, një jobesimtar, një njeri xhunub apo një grua në ciklin mujor.

¹ El-Furkan: 48

² Buhariu 744, Muslimi 1353, Ebu Daudi 781, Nesai 60,894, Ibën Maxheh 805.

³ Ebu Daudi 83, Nesai 333, Tirmidhiu 69, Ibën Maxheh 386,387,388, Ahmedi 2/361, Maliku 1/44-45.

⁴ Buhariu, Muslimi dhe Ahmedi.

- Uji në të cilin ka pirë një jobesimtar:
Allahu thotë në Kuran:
إِنَّمَا الْمُشْرِكُونَ نَجَسٌ “Me të vërtetë, idhujtarët janë të papastër”¹
Duhet pasur parasysh se ky ajet nuk i referohet gjendjes së tyre fizike, por asaj shpirtërore për shkak të besimeve të kota që ata praktikojnë. Ata mund të kenë kontakt me papastërtitë, por kjo nuk do të thotë se trupat e tyre janë të papastër. Në fakt, këta njerëz kishin lidhje të ndryshme me myslimanet. Emisarët dhe delegacionet e tyre e vizitonin të Dërguarin e Allahut ﷺ si dhe hynin në xhaminë e tij. I Dërguari ﷺ nuk urdhëronte asnjëherë që të pastroheshin objektet e prekura prej tyre.
- Uji në të cilin ka pirë një grua në ciklin mujor:
Sa i përket grave në ciklin mujor, padyshim që uji në të cilin kanë pirë ato është i pastër.
Aishja r.a. tregon: “Unë pija ujë nga një enë, ndërkohë që isha me cikël mujor. Pastaj ia kaloja atë të Dërguarit të Allahut ﷺ dhe ai pinte nga i njëjti vend ku unë kisha vendosur buzët”.²
- Uji i mbetur në të cilën ka pirë kafsha:
Lejohet përdorimi i ujit të mbetur në një enë pasi në të ka pirë një kafshë mishi i së cilës është hallall. Ky ujë konsiderohet i pastër ngase jargët (pështyma) burojnë nga mishi i pastër, prandaj dhe uji ka marrë të njëjtën dispozitë.
Ebu Bekër ibn ElMundhir ka thënë: “Dijetarët kanë rënë dakord që ky lloj uji është i lejuar për pirje si dhe për t’u përdorur për avdes”.

Vini re: Uji në të cilin kanë pirë kafshët mishi i të cilave nuk hahet, është i pastër me kusht që të mos kishte ndryshuar njërën nga tre cilësitë: erën, ngjyrën apo shijen.

Ndërsa uji në të cilin ka pirë qeni dhe derri, llogaritet i papastër.
- Uji i mbetur në një enë në të cilën ka pirë macja:
Ky ujë llogaritet i pastër. Kjo nënkuptohet nga hadithi që transmeton Këshe bint Keab, ku thotë se Ebu Katade r.u. hyri në dhomë dhe ajo i nxori ujë për të pirë. Në ato momente erdhi një mace për të pirë ujë dhe Ebu Katade r.u. e anoi pak enën, në mënyrë që macja të pinte prej saj. Këshe tregon: “Ai e vuri re se po e shikoja dhe më pyeti: “A po habitesh?” Unë ju përgjigja: “Po”.

¹ Et-Teube: 28

² Muslimi 690, Ebu Daudi 259, Nesai 70,278,281,340, Ibën maxheh 643, Ahmedi 6/2011vf60.

Pastaj ai tha: “I Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “*Ajo nuk është e papastër. Ajo rri me ju*”.¹

- Uji i ndryshuar:

Në këtë kategori hyn ai ujë, gjendja e të cilit ka pësuar ndryshim, si rezultat i qëndrimit për një kohë të gjatë në një vend apo për arsye të vendit ku është vënë si dhe për shkak të përzierjes me ndonjë lëndë që nuk mund të hiqet plotësisht prej tij (ujë me alga, gjethe peme e kështu me radhë).

Dijetarët kanë rënë dakord që uji i ndryshuar bën pjesë tek lloji i ujit absolut. Shpjegimi është i thjeshtë: Çdo gjë që hyn në kategorinë e kuptimit të përgjithshëm të ujit, pa pasur ndonjë cilësi tjetër, konsiderohet i pastër, sepse në Kuran thuhet:

فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا

“...dhe nëse nuk gjeni ujë, atëherë merrni tejemmum me dhe të pastër...”²

2. Ujë Taahir (طاهر):

Ujë Taahir: është i njëjti ujë Tahuur, por ai është ujë i cili ka ndryshuar ndonjë prej 3 cilësive të tija me diç të pastër.

D.m.th është ujë i pastër në vete mirëpo nuk mundët që të përdoret për pastrim.

Në këtë kategori hyn: uji i përzier me lëndë si: sapuni, shafrani, lulet etj., të cilat përfshihen në grupin e lëndëve që konsiderohen të pastra nga Sheriati. Ky ujë konsiderohet i pastër për aq kohë sa nuk përziehet me lëndë të tjera që mund t’ia ndryshojnë gjendjen e tij dhe që pas kësaj përzierjeje nuk mund të quhet më ujë. Nëse ndodh kjo, uji konsiderohet ende i pastër, por nuk mund të përdoret për pastrim.

Nëse uji përziehet më diç të pastër, mirëpo kjo lëndë nuk ka mundësinë që ta ndryshon realisht gjendjen e ujit, atëherë ky ujë llogaritet i pastër (Tahuur), që d.m.th se lejohet që të përdoret për pastrim. Argument për këtë është hadithi i Umu A’tijes r.a. e cila tregon se i Dërguari i Allahut ﷺ hyri në shtëpinë e saj pas vdekjes së vajzës së tij Zejnebit r.a. dhe i tha:

¹Ebu Daudi 75, Nesai 68,340, Tirmidhiu 92, Darimi 1/187-188, Ibën maxheh 1/131, El Hakim 1/159-160, Bejhakiu 1/245, Ahmedi 5/303,309.

² El-Maide: 6

“Laje atë tre apo pesë herë ose edhe më tepër nëse e shihni të arsyeshme, duke përdorur ujë dhe Sidr. Për larjen e fundit përdor pak kamfur apo diç nga ai. Kur të kesh mbaruar, më njofto!”. Pasi ajo veprimi siç i kishte thënë i Dërguari ﷺ, ai u dha grave veshjen e tij të jashtme dhe u tha atyre që ta mbështillnin Zejnebin r.a. me të”¹.

3. Ujë Nexhis (نجس): Ujë i papastër

Uji Nexhis: është uji të cilit i ka ndryshuar era, shija apo ngjyra e tij si pasojë e ndonjë papastërtie të rënë në të.

Në këtë rast, ky ujë nuk mund të përdoret më për pastrim.

Sipas Ibn ElMundhir dhe Ibn ElMulakin, ekziston një konsensus i dijetarëve për këtë çështje.

Ndryshimi i këtyre tre cilësive të ujit është parim i fortë i cili ia lehtëson njeriut njohjen e ujit Tahuur nga dy llojet tjera.

Nëse ujit i është ndryshuar një prej këtyre cilësive me diçka të pastër, atëherë kemi të bëjmë me ujë Taahir, mirëpo nëse ujin e ka ndryshuar diçka e papastër, atëherë kemi të bëjmë me ujë Nexhis.

Nëse uji vazhdon ende të jetë në origjinën e tij, gjë që do të thotë se lënda e papastër, e përzier me të, nuk ka arritur t’ia ndryshojë shijen, ngjyrën apo aromën e tij, si i tillë konsiderohet i pastër dhe i njëjti mund të përdoret për pastrim.

Dispozita mbi ujin e përdorur për pastrim

Uji i mbetur prej avdesit apo guslit, a llogaritet Tahuur dhe a lejohet pastrimi me të?

Kjo mesele është e njohur tek dijetarët e Fikhut, andaj të gjithë dijetarët e kanë përmendur këtë në kapitullin e pastërtisë. Më lartë përmendëm se ajo e cila e dallon ujin Tahuur nga ujërat tjerë janë cilësitë e këtij uji, andaj kemi thënë se nëse uji nuk ka ndryshuar njërën prej tre cilësive të tij është i pastër (Tahuur) dhe lejohet të përdoret për pastrim.

Argument për këtë është thënia e të Dërguarit ﷺ: "Uji me të vërtetë është Tahuur (i pastër) dhe nuk e ndot asgjë"² që d.m.th se esenca e ujit është pastërtia, derisa të

¹Buhariu 1253,1254,1258,1260, Muslimi 2165, Ebu Daudi 3142,3146, Tirmidhiu 990, Nesai 1880,1885,1886, Ibën Maxheh 1458,1459.

² Ahmedi 11257, Nesaiu 326

vërtetohet e kundërta, ndërsa papastërtia nuk vërtetohet vetëm nëse njëra nga tre cilësitë e ujit kanë pësuar ndryshim për shkak të ndonjë papastërtie.

Uji i dyshuar

Dyshimi në Sheriat është: *t'i konsiderosh dy çështje të mundshme, pa përparësi të njëjës mbi tjetrën.*

Çështja e lartpërmendur njashtu lidhet me kriterin dhe rregullin e përmendur më lartë, se uji llogaritet i pastër derisa të ndryshon një, apo më shumë cilësi me diçka të papastër.

Njashtu është e lidhur me një rregull të Fikhut: "Bindja nuk zhbëhet me dyshim" dhe ky rregull është prej parimeve më të forta të Fikhut dhe Fesë së Allahut të Madhëruar në përgjithësi dhe është i bazuar në argumente të shumta të Kuranit dhe Sunetit.

Kapitulli [II] - Enët dhe dispozitat e tyre

Ena është send i lugët (i harkuar, i përkulur) me anë të ngritura, me trajta e përmasa të ndryshme, prej balte të pjekur, qelqi, metali, plastike, apo ndonjë material tjetër i cili përdoret për të mbajtur në të lëngje apo lëndë të tjera. Esenca e tyre është lejimi, siç thotë Allahu i Madhëruar:

هُوَ الَّذِي خَلَقَ لَكُمْ مَا فِي الْأَرْضِ جَمِيعًا

"Ai është i cili ka krijuar për ju gjithçka që ka në tokë..."¹

Përdorimi i enëve nga ari dhe argjendi

Lejohet përdorimi i të gjithë enëve në ngrënie, pirje, apo në diçka tjetër, me kusht që të jenë të pastra dhe të lejuara².

Lejohet përdorimi i këtyre enëve edhe nëse janë të shtrenjta, sepse esenca në këto çështje është lejueshmëria.

Mirëpo nga ky parim përjashtohen enët e arit dhe argjendit, të cilat nuk lejohet të përdoren për ngrënie dhe pije, edhe pse të njëjtat lejohet përdorimi i tyre në aspekte tjera, ngase i Dërguari ﷺ ka thënë: *"Mos pini prej enëve të arit e të argjendit! Mos hani prej enëve të arit dhe të argjendit, ari dhe argjendi janë për ata (mosbesimtarët) në këtë botë, ndërsa për ju në botën tjetër."*³

Njashtu thotë i Dërguari ﷺ: *"Ai që pi prej enëve të arit dhe të argjendit, me të vërtetë në barkun e tij e ndez zjarrin e Xhehenemit."*⁴

Këto hadithe janë argument i qartë për ndalesën e përdorimit të këtyre enëve në ngrënie dhe pije, mirëpo në to nuk ka argument se ndalohet përdorimi i tyre në pastrim apo në diç tjetër.

Njashtu kjo ndalesë përfshin enët të cilat janë plotësisht apo pjesërisht prej ari ose prej argjendi, si edhe enët të cilat vetëm shtresën e jashtme e kanë prej arit apo argjendit.

Nëse ena është e çarë dhe pastaj ngjitet me ar, ndalohet përdorimi i saj. E nëse ngjitet me argjend, duke mos pasur material tjetër për ta ngjitur dhe sasia e argjendit

¹ El-Bekare:29

²Të lejuara, p.sh mos të jenë të vjedhura apo mos të jenë prej enëve të ndaluara që do të përmenden në këtë pjesë.

³ Buhariu (5426) dhe Muslimi (2067).

⁴ Buhariu (5634) dhe Muslimi (2065).

është e pakët, përdorimi i saj lejohet. Transmeton Enesi r.a. i cili thotë: “Të Dërguarit ﷺ iu thye shala, ndërsa ai e lidhi atë me zinxhir të argjendtë”.¹

Përdorimi i enëve të jobesimtarëve

Në esencë enët e jobesimtarëve janë të lejuara, përveç nëse dihet se janë të papastra. Në atë rast nuk lejohet përdorimi i tyre, vetëm pasi që të pastrohen. Transmetohet prej Ebu Tha'alebe ElKusheni r.u. se ka thënë :*"I thash; O i Dërguar i Allahut ﷺ, ne jetojmë në tokë të Ehlu kitabëve², a të hamë prej enëve të tyre?" I Dërguari ﷺ tha: "Mos hani prej tyre, përpos nëse nuk mund të gjeni (enë) tjera, atëherë lani ato dhe hani prej tyre."*³

Mirëpo, nëse nuk dihet a janë të pastra, por pronarët jobesimtarë të këtyre enëve njihen si njerëz të cilët nuk i shfrytëzojnë enët për të përgatitur në to ushqime të papastra, atëherë lejohet përdorimi i tyre. Këtë e vërteton rasti kur: *i Dërguari ﷺ dhe sahabet e tij shfrytëzuan ujë për avdes nga një enë e një mushrikes.*⁴

Po ashtu Allahu i Madhëruar na e ka bërë ushqimin e Ehli Kitabëve të lejuar dhe këtë ushqim ndodh që ata të na e shërbejnë në enët e tyre, ashtu siç ndodhi me të Dërguarin ﷺ kur një prej Hebrejve e kishte ftuar në ushqim dhe i Dërguari ﷺ hëngri nga buka e elbit dhe nga gjalpi i cili kishte marrë pak erë.⁵

¹Buhariu:3109

²Pasues të Librit: Krishterët dhe Hebrejtë.

³ Buhariu (5478) dhe Muslimi (1930).

⁴ Buhariu (344) dhe Muslimi (682).

⁵Ahmedi (3/210-211), Albani e ka cilësuar si sahih.

Përdorimi i enëve të cilët janë nga lëkura e kafshëve të ngordhura

Nëse lëkura e kafshës së ngordhur regjet atëherë përdorimi i saj bëhet i lejuar dhe atë duke u argumentuar nga fjala e Dërguarit ﷺ “Çdo lëkurë që regjet, bëhet e pastër”¹

Gjithashtu transmetohet se i Dërguari ﷺ kaloi pranë një deleje të ngordhur dhe tha: “A nuk përfituan nga kjo lëkurë duke e regjur atë” i thanë: “ajo është cofëtinë” i Dërguari ﷺ tha: “Ajo e cila është ndaluar është ngrënia e saj”.²

Duhet pasur parasysh se kjo rregull vlen vetëm për atë kafshë të ngordhur, mishi i të cilës është i lejuar nëse ajo do ishte therur.

Ndërsa sa i përket leshit të kafshës së cofur ushqimi i së cilës kur është e gjallë është i lejuar, lejohet dhe është i pastër, ndërsa mishi i të njëjtës është i papastër dhe i ndaluar.

Allahu i Madhëruar thotë:

إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ حَمًّا خَنْزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ

“...përveç në qoftë se ai (ushqimi) është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë...”³

Regjja bëhet duke larguar ndyrësirën dhe papastërtinë e cila gjendet në lëkurë, dhe atë me anë të gjërave të cilat përzihen me ujë siç është kripa, apo bimët e njohura si: mimoza, dëllinja etj.

Ndërsa lëkura e kafshëve mishi i të cilës nuk hahet, nuk pastrohet, edhe sikur ajo të jetë therur.

Shembull: dhelpra, ujku, ariu, macja apo kafshë të tjera sikur ato, lëkura e tyre pasi të cofin nuk pastrohet edhe pse kur ishte e gjallë ishte e pastër.

Pra, lëkura e çdo kafshe mishi i së cilës nuk hahet nuk mund të pastrohet me regjje.

Përfundim: Kafsha mishi i të cilës hahet, nëse ajo është therur – lëkura e saj është e pastër.

¹Tirmidhiu 165 , Muslimi 366 nga hadithi Ibn Abasit ku thuhet: “Çdo lëkurë e cila regjet është pastruar”

² Muslimi 363, IbnMaxhe 3610

³ Enam:145

Kapitulli [III] - Etikë e kryerjes së nevojës

Istinxhaja dhe Istixhmari

Istinxha: Është mënjanimi me ujë i asaj që del nga dy rrugët e jashtëqitjes.
Istixhmar: Është mënjanimi i asaj që del nga dy rrugët e jashtëqitjes duke e fshirë me gurë apo diç tjetër të lejuar.

Këta dy mënyra pastrimi janë zëvendësues të njëri tjetrit, siç ka ardhur në hadithin që e transmeton Enesi r.u. se: *“I Dërguari ﷺ ka hyrë në vendin e kryerjes së nevojës, ndërsa unë me një bashkëmoshatar timin ia bartnim një enë të vogël nga lëkura me ujë dhe bastunin e tij (shkopi që e përdorin pleqtë) dhe pastrohej me ujë”*.¹

Gjithashtu transmetohet nga Aisha r.a. se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: *“Nëse ndonjëri nga ju shkon për ta kryer nevojën le të pastrohet me tre gurë, sepse ata janë të mjaftueshëm për të”*.²

Bashkimi i dy mënyrave të pastrimit është më i mirë.

Istixhmari – është mënyrë pastrimi e cila bëhet me anë të gurëve, apo çdo gjëje tjetër të lejuar e cila i zëvendëson gurët dhe kryen funksionin e tyre, siç janë: fashat e letrës, letra, copat e drurit, etj.

I Dërguari ﷺ pastrohej me gurë dhe të njëjtin gjykim ia jepte edhe gjërave tjera që e kryenin funksionin e gurit në pastrim.

Nëse pastrimi bëhet me gurë apo diç të ngjashme nuk llogaritet pastrim i pranuar nëse nuk bëhen së paku tri fshirje të organit më të, dhe atë duke u argumentuar me hadithin e Selmanit r.u. i cili thotë: *“Na ka ndaluar i Dërguari ﷺ që të pastrohemi me të djathtën, të pastrohemi me më pak se tre gurë, të pastrohemi me bajgën e thundrakeve dhe të pastrohemi me asht”*.³

¹ Muslimi 271,

² Ahmeti 6/108, DarKutni 144,

³ Muslim 262

Kthimi në drejtim të Kibles apo në të kundërtën e saj gjatë kryerjes së nevojës

Nuk lejohet kthimi në drejtim të Kibles apo në të kundërtën e sajë gjatë kryerjes së nevojës në vend të hapur ku nuk ka pengesë.

Transmeton Ebu Ejub ElEnsari r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Kur të shkoni për të kryer nevojën mos u ktheni në drejtim të Kibles e as mos u ktheni në të kundërtën e saj, por kthehuni kah lindja apo kah perëndimi”*.

Thotë Ebu Ejub ElEnsari r.u.: Kur shkuam në Sham pamë se vendet për kryerjen e nevojës ishin të kthyera kah Qabeja, kur hynim në ta ktheheshim në një anë dhe kërkonim falje nga Allahu.¹

Mirëpo, nëse nevojtorja është në ndërtesë, apo mes njeriut dhe Kibles ka pengesë që e mbulon atë, atëherë kjo nuk është mëkat, dhe atë duke u argumentuar me hadithin që e transmeton Ibn Omeri r.u. i cili tregon se: *“E ka parë të Dërguarin ﷺ duke kryer nevojën i kthyer në drejtim të Shamit ndërsa me shpinë i kthyer në drejtim të Qabes.”*²

Gjithashtu hadithi i Mervan Al Asgar r.u. i cili thotë: Ibn Omeri r.u. e uli devenë në drejtim të Qabes dhe u ul pranë saj për ta kryer nevojën e vogël. I thash: O baba i AbduRahmanit a nuk është kjo e ndaluar. Tha: po, por kështu është ndaluar që të veprojmë në vend të hapur, ndërsa nëse ka mes teje dhe Kibles diçka e cila të mbulon atëherë nuk ka diç të keqe.³

Ndërsa më e mira është që të kujdesemi edhe në vende të mbyllura të mos kthehemi në atë drejtim, Allahu e din më së miri.

¹Buhariu 144 , Muslimi 264

² Buhariu: 148, Muslimi: 266

³ EbuDavudi: 11

Veprat e pëlqyera gjatë hyrjes në nevojto

- Para hyrjes në nevojto është sunet të thuhet:

Bismilah, Allahume ini eudhu bike minel khubthi vel khabaithi
 (Në emër të Allahut, o Zot, më ruaj nga e ndyta dhe nga ndyrësirat).

Transmeton Enesi r.u. se i Dërguari ﷺ kur hynte në nevojto thoshte: “O Zot, më ruaj nga e ndyta dhe nga ndyrësirat”.¹

Gjithashtu transmeton Aliu r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Perdja në mes syve të xhinit dhe pjesëve të zbuluara të trupit të njeriut kur hyn në nevojto, janë fjalët: Bismil-lah (në emër të Allahut).”²

- Ndërsa kur del nga nevojto thotë: **Gufraneke** (Kërkoj faljen Tënde).

Transmeton Aisha r.a. se i Dërguari ﷺ kur dilte nga nevojto thoshte: “Kërkoj faljen Tënde”.³

- Hyn në nevojto me këmbën e majtë ndërsa del me këmbën e djathtë, dhe nuk duhet të zhvesh rrobat që ti duken vendet e turpshme derisa ti afrohet tokës. Transmeton Ibn Omeri r.u. se i Dërguari ﷺ kur shkonte për nevojë nuk e ngrinte rrobën e tij pa u afruar në tokë.⁴

- Nëse është në vend të hapur është e pëlqyer që të largohet dhe të struket që të mos duket.

Argument për këtë është hadithi i Xhabirit r.u. i cili thotë: “Morëm rrugë me të Dërguarin ﷺ dhe nuk ka ndodhur të shkonte për nevojë në ndonjë vend e të mos fshihej prej nesh që të mos dukej”.⁵

¹Buhariu 142, Muslimi 375

²IbnMaxhe 297, Tirmidhiu 606, Albani: Sahih, Ahmed Shakir: hasen

³EbuDavudi 17, Tirmidhiu 7, Albani: hasen

⁴EbuDavudi 14, Tirmidhiu 14, Albani: Sahih

⁵EbuDavud 2, IbnMaxhe 335, I vërtetë

Cka e ka të ndaluar të veprojë ai i cili dëshiron të kryej nevojën

- Është i ndaluar urinimi në ujin i cili nuk lëviz, dhe atë duke u argumentuar me hadithin e Xhabirit r.u. i cili thotë: “Ka ndaluar i Dërguari ﷺ urinimin në ujin i cili nuk lëviz”.¹
- Gjithashtu nuk duhet prekur organin e as të pastrohet me dorën e djathtë. Thotë i Dërguari ﷺ:” Kur të shkon dikush nga ju për kryerjen e nevojës të mos e prek organin e tij me të djathtën e as të mos pastrohet me të djathtën”.²
- Ndalohet kryerja e nevojës në rrugë, ndër hije, në kopshte publike, ndër drunjtë që kanë fryte apo në burimet e ujit.

Transmeton Muadhi r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Ruajuni nga tri gjëra që shkaktojnë mallkimin: kryerja e nevojës në burime të ujit, në rrugë dhe nën hije të pemëve”.³

Gjithashtu transmeton Ebu Hurejra r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Ruajuni nga dy të mallkuar. Sahabët e pyetën: “Cilët janë këta të mallkuar, o i Dërguari i Allahut?” Ai u përgjigj: Ai që e kryen nevojën në rrugë nëpër të cilën ecin njerëzit, ose në hije ku ata pushojnë”.⁴

- Ndalohet leximi i Kuranit dhe dhikri
- Ndalohet pastrimi me jashtëqitjen e kafshëve (bajga), me asht, apo me ushqim.

Transmeton Xhabiri r.u. se: “I Dërguari ﷺ ka ndaluar që të pastrohet (fshihet) me eshtër apo bajgë”.⁵

- Ndalohet kryerja e nevojës në varre te myslimanëve, thotë i Dërguari ﷺ: “Nuk ka dallim a në mes të varreve e kryen nevojën apo në mes të tregut”.⁶

¹Muslimi 281, Buhariu 239

²Buhariu 154, Muslimi 267

³EbuDavud 26, IbnMaxhe 328

⁴Muslim 269

⁵Muslim 263

⁶IbnMaxhe 1567

Veprat e urryera për atë i cili kryen nevojën

- Është e papëlqyer që kryerja e nevojës të bëhet në vende ku frynë erë, nëse njeriu para vetes nuk ka ndonjë pengesë që ia ndalon kthimin e urinës tek ai.

- Gjithashtu është e papëlqyer të flitet.

Është transmetuar nga i Dërguari ﷺ se: “*Një person i dha selam të Dërguarit ﷺ derisa ai ishte duke kryer nevojën, por i Dërguari ﷺ nuk ia ktheu atij.*”¹

- Është e papëlqyer që njeriu të kryen nevojën në çarje apo vrima të tokës. Transmeton Katade nga Abdullah bin Serxhes r.u. se i Dërguari ﷺ ka ndaluar që të urinohet në vrima (gropa). Është pyetur Katadja: Pse, çka kanë vrimat ? Tha: Ato janë vendbanime të xhinëve.²

Gjithashtu nuk është mirë sepse njeriu mund të sulmohet dhe dëmtohet nga ndonjë gjallesë e cila mund të jetë në atë vrimë.

- Është e papëlqyer që në nevojtoje të hyhet me ndonjë gjë e cila përmban përmendje të Allahut (dhikr), sepse: “*I Dërguari i Allahut kur hynte në nevojtoje, unazën e tij e linte jashtë*”.³

E nëse kjo është e patjetërsueshme dhe e nevojshme atëherë lejohet, por duke mos qenë të ekspozuara, por të vendosura në çantë apo xhep.

Ndërsa sa i përket Kuranit është e ndaluar të hyhet me të pa marrë parasysh a e ekspozojmë apo jo, dhe atë si shkak i respektit ndaj fjalës së Allahut e cila është fjala më e ndershme. E nëse hyhet me të në nevojtoje atëherë kjo është mosrespektim ndaj këtij libri.

¹Muslimi 370

², EbuDavud:29, Nesaiu:34

³EbuDavud 19, Tirmidhi 1746, Nesai 5228

Kapitulli [IV] - Misvaku dhe sunetet e fitres (praktikat e natyrshmërisë)

Misvaku

Misvaku është përdorimi i drurit të Arakut për pastrimin e dhëmbëve apo mishit të tyre, me qëllim të mënjanimin të ushqimeve apo erërave.

Dispozita e tij

Misvaku është vepër e pëlqyer dhe sunet të përdoret në çdo kohë. Madje edhe agjëruesit i lejohet misvaku gjatë agjërimit pa marrë parasysh a është në fillim të ditës së agjërimit apo në fund të saj.

I Dërguari ﷺ na ka nxitur në përdorimin e tij në përgjithësi dhe nuk e ka kushtëzuar atë në ndonjë kohë të veçantë.

Thotë i Dërguari ﷺ : “Misvaku është pastrim i gojës, kënaqësi e Krijuesit”.¹

Gjithashtu i Dërguari ﷺ ka thënë: “Mos të kisha frikë që e ngarkoj umetin tim, do tua kisha bërë obligim misvakun para çdo namazi”.²

Kur është sunet?

- Është sunet gjatë avdesit, pas zgjimit nga gjumi, gjatë ndryshimit të erës së gojës, para leximit të Kuranit, para namazit.

- Gjithashtu është sunet gjatë hyrjes në xhami dhe në shtëpi.

Transmeton Kudam bin Shurejh nga babi i tij se ka thënë: “E kam pyetur Aishen r.a. duke i thënë: cila ishte vepra e parë të cilën e bënte i Dërguari ﷺ kur hynte në shtëpi, tha: përdorimi i misvakut”.³

- Gjithashtu është sunet të përdoret gjatë heshtjes së gjatë apo nëse dhëmbët zverdhen.

Transmetohet se “I Dërguari ﷺ kur u zgjonte natën e pastronte gojën e tij me misvak”.⁴

Prandaj besimtari është i urdhëruar që para kryerjes së ndonjë adhurimi apo vepre që të afron tek Allahu të jetë në gjendjen më të mirë dhe të jetë sa më i pastër.

¹ Buhariu 2/40, Ahmedi 6/47, Nesaiu 1/10

² Buhariu 887, Muslimi 252

³ Muslimi:253

⁴ Buhariu 245, Muslimi 255

Çka përdoret si Misvak?

Është sunet që misvaku të jetë nga druri Arak i njomë i cili nuk copëtohet, nuk e lëndon gojën. Kështu vepronte i Dërguari ﷺ.

Lejohet përdorimi i misvakut me dorën e djathtë dhe të majtën dhe nuk ka diç të keqe në të.

Nëse nuk ka Misvak që ta përdor gjatë avdesit për pastrimin e gojës, mund ti pastrojë me brushë të dhëmbëve apo ti fërkojë dhëmbët me gisht si zëvendësim. Një gjë të tillë e transmeton Aliu r.u. në përshkrimin e mënyrës së marrjes avdes të Dërguarit ﷺ¹

Dobitë e Misvakut

Dobia më e rëndësishme është ajo e cila u cek në hadithin e lartpërmendur: se ai është pastrim i gojës në Dynja dhe kënaqësi e Krijuesit në Ahiret. Andaj duke pasur parasysh dobitë e misvakut duhet që besimtari ta praktikojë këtë sunet dhe të mos e lë atë.

Janë përmendur edhe dobi të tjera të misvakut siç janë: forcimi i dhëmbëve dhe i mishit të tyre, pastrimi i zërit dhe të bërit njeriun më aktiv.

¹Ahmedi 1/158, IbnHaxheri Sahih

Sunetet e fitres (natyrshmërisë)

Sunetet e fitres përndryshe quhen edhe veçoritë e natyrshmërisë, sepse vepruesi i tyre cilësohet me natyrshmërinë në të cilën Allahu i Madhëruar i ka krijuar njerëzit dhe të njëjtën ua ka bërë të dashur, me qëllim që të jenë në formën më të mirë dhe më të përsosur.

Transmeton Ebu Hurejra r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Pesë sende janë nga natyra e fitres: pastrimi i vendeve të turpshme (mënjanimi i qimeve), bërja synet, shkurtimi i mustaqeve, mënjanimi i qimeve nga nënsqetullat dhe shkurtimi i thonjve”*.¹

1. Pastrimi i vendeve të turpshme

Pastrimi i vendeve të turpshme nënkupton mënjanimin e qimeve që rriten rreth organeve gjinitale me anë të metalit (brisk, zhiletë, etj.).

Heqja e tyre është pastërti dhe zbukurim, ndërsa lejohen të hiqen edhe në mënyra tjera përveç briskut.

2. Të bërit synet:

Synetimi është: Prerja e lafshës që mbulon kokën e organit gjental të mashkullit, në atë masë derisa të duket koka.

Kjo sa u përket meshkujve, ndërsa tek gratë është për qëllim prerja (shkurtimi) e buzëve të organit gjental femëror.

Të bërit synet tek meshkujt është vaxhib ndërsa tek femrat sunet.

Urtësia e të bërit synet është mënjanimi i ndyrësirave që formohen nën lëkurën e cila mënjanohet gjatë synetimit, por ka edhe dobi tjera.

Ndërsa tek femra ul epshin e tepruar.

Është e pëlqyer që synetimi të jetë në ditën e shtatë pas lindjes, sepse kjo është më e lehtë për shërim dhe fëmija rritet në formën më të mirë.

¹ Buhariu 5889, Muslimi 257

3. Shkurtimi i mustaqeve:

Shkurtimi i mustaqeve nënkupton: shkurtimin e tepërt të tyre, sepse në të ka zbukurim, pastërti dhe është kundërshtim i traditave të mosbesimtarëve.

Kanë ardhur hadithe të vërteta të cilat nxisin në shkurtimin e mustaqeve dhe lëshimin e mjekrës, zgjatjen dhe mirëmbajtjen e saj, dhe atë si shkak i rrolit të mjekrës si në bukurinë ashtu edhe në burrërinë e mashkullit.

Ndërsa sot fatkeqësisht shumë nga burrat e kanë ndryshuar këtë natyrshmëri duke i lëshuar mustaqet dhe hequr mjekrat, apo duke i shkurtuar tepër ato.

E gjithë kjo është kundërshtim i sunetit dhe urdhrave që kanë ardhur për obligimin e rritjes së mjekrës.

Transmeton Ebu Hurejra r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Shkurtoni mustaqet, lëshoni mjekrat dhe kundërshtoni mexhusët”*¹.

Gjithashtu transmeton Ibn Omeri r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Kundërshtoni mushrikët, shkurtoni mustaqet dhe lëshoni mjekrat”*²

Prandaj besimtari duhet ti përmbahet këtij udhëzimi i të Dërguarit ﷺ, ti kundërshton armiqtë dhe të mos ngjason me gratë.

4. Prerja e thonjve:

Me prerjen e thonjve nënkuptojmë shkurtimin e tyre duke mos i lënë të rriten. Me prerje ata zbukurohen dhe njëkohësisht mënjanoohen ndyrësitrat që gjenden ndër ta. Edhe këtë sunet i të Dërguarit ﷺ e kanë kundërshtuar disa besimtarë dhe kanë filluar ti zgjasin thonjte e tyre, ose vetëm njërin thua.

E gjithë kjo është nga zbukurimi që ua bën shejtani edhe pasim i armiqtë të islamit.

5. Shkulja e qimeve të sqetullave:

Me shkuljen e qimeve të sqetullave, kemi për qëllim largimin e qimeve të cilat rriten në sqetulla.

Është e preferuar që këto qime të largohen me shkulje, brisk (zhiletë) apo me ndonjë mënyrë tjetër, dhe atë si shkak i pastërtisë dhe evitimit të erërave të padëshiruara të cilat lindin shkak i tyre.

¹ Muslimi 260

² Buhariu 5892, Muslimi 258

Transmeton Enesi r.u. i cili thotë: *“Na ka kufizuar i Dërguari ﷺ në shkurtimin e mustaqeve, në rruajtjen e qimeve nga pjesët intime, në shkuljen e qimeve nga sqetullat dhe në prerjen e thonjve që të mos i lëmë ato më shumë se dyzet ditë”*¹

Kjo është pra feja jonë e pastër, e cila na ka urdhëruar me këto veçori, me qëllim të arritjes së bukurisë, pastrimit dhe pastërtisë, që besimtari të jetë në gjendjen më të mirë, larg pasimit të mosbesimtarëve dhe të paditurve, duke qenë krenarë me fenë e tij, respektues i Zotit të tij dhe pasues i të Dërguarit ﷺ.

Këtyre pesë vetive i shtohet edhe: Misvaku, larja e hundës me ujë, pastrimi ndërmjet gishtërinjve, istinxhaja (pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojës), dhe atë duke u bazuar në hadithin e Aishes r.a. e cila transmeton se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Dhjetë gjëra janë prej fitres: shkurtimi i mustaqeve, lëshimi i mjekrës, përdorimi i misvakut, larja e hundës me ujë, pastrimi i ndërmjet gishtërinjve, prerja e thonjve, shkulja e qimeve nga sqetullat, mënjanimi i qimeve nga vendet e turpshme dhe pastrimi me ujë pas kryerjes së nevojës së madhe.”*

Transmetuesi Musab ibn Shejbe thotë se e ka harruar të dhjetën, por ka mundësi të jetë shpëlarja e gojës.²

¹ Muslimi: 412

² Transmeton Muslimi 261

Kapitulli [V] - الوضوء Avdesi

Definicioni dhe dispozita e Avdesit

Përkufizimi gjuhësor: *Elvudu* nënkupton bukurinë dhe pastërtinë.

Përkufizimi terminologjik: Përdorimi i ujit në katër gjymtyrët: fytyrë, duar, kokë dhe këmbë, sipas mënyrës së caktuar me Sheriat me qëllim të adhurimit të Allahut të Madhëruar.

Dispozita:

Është vaxhib për personin i cili nuk ka avdes nëse dëshiron kryerjen e ndonjë adhurimi për të cilin avdesi është kusht, si namazi, tavafi,..etj.

Argumentimi për obligueshmërinë e tij.

Argument për obligueshmërinë e Avdesit është fjala e Allahut:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ وَأَرْجُلَكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ
“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjtë...”¹

I Dërguari ﷺ thotë: *“Allahu nuk pranon namazin që është falur në gjendje papastërtie e as lëmshën e vjedhur”*.²

Gjithashtu i Dërguari ﷺ thotë: *“Allahu nuk e pranon namazin e atij njeriu, cili e prish avdesin e tij, derisa të merr avdes përsëri”*.³

Nuk është transmetuar mospajtimit nga asnjëri nga myslimanët për këtë çështje, andaj themi se avdesi është obligim i vërtetuar me Kuran, sunet dhe konsensus të dijetarëve.

¹ El-Maide: 06

² Muslimi 224

³ Muslimi 223

Për kë obligohet?

Është obligim për çdo besimtar të mençur i cili ka hyrë në moshën e pjekurisë nëse ai dëshiron kryerjen e ndonjë adhurimi kusht i të cilit është avdesi.

Kur obligohet?

Themi se nuk ka kohë të caktuar, por kur dëshiron njeriu kryerjen e ndonjë adhurimi kusht i të cilit është avdesi, atëherë i obligohet marrja e avdesit.

Kushtet e Avdesit

Që avdesi të jetë i vlefshëm kërkohen disa kushte:

a) Islami, mendja dhe moshja.

Pra nuk pranohet nga jomyslimani, i çmenduri, e as nga një fëmijë i cili nuk ka arritur moshën në të cilën di ti dalloj sendet.

b) Nijeti

Thotë i Dërguari ﷺ: *“Veprat vlerësohen sipas nijetit..”¹*.

Nijeti është me zemër dhe nuk shqiptohet, pasi që diçka e tillë nuk na është transmetuar nga i Dërguari ﷺ.

c) Uji pastrues (Tahuur)

Siç është përmendur më herët, uji i pastër jo pastrues (Taahir) dhe i papastër (Nexhes) nuk vlen për avdes.

d) Largimi i pengesave që ndalojnë arritjen e ujit në lëkurë, siç është: dylli, brumi, llaku i thonjve, etj.

e) Pastrimi pas nevojave fiziologjike mes istixhmarit apo istinxhas.

f) Vazhdimësia (Mos ndërprerja e larjes gjatë avdesit).

I Dërguari ﷺ kur merrte avdes nuk bënte ndërprerje gjatë tij, siç transmeton Khalid bin Midan se:” *i Dërguari ﷺ e pa një njeri i cili ishte duke u falur ndërsa në*

¹Buhariu 1, Muslimi 1907

thembrën e tij ishte një pjesë sa një monedhë e cila nuk ishte lagur me ujë. Atë, i Dërguari e urdhëroi që ta përsërisë avdesin”.¹

E sikur të mos ishte pasimi i detyrueshëm nuk do ta urdhëronte i Dërguari ta përsërisë tërë avdesin, por vetëm pjesën e pa lagur.

g) Radhitja

Radhitja është e detyrueshme sepse Allahu i Madhëruar e ka përmendur si të tillë, dhe me të njëjtën radhitje morri avdes i Dërguari ﷺ.

Pra ashtu siç u përmend në Kuran, së pari duke larë fytyrën, pastaj duart, pastaj kokën, pastaj këmbët. E njëjta radhitje është transmetuar nga Abdullah bin Zejd dhe të tjerë të cilët tregojnë mënyrën e marrjes avdes të Dërguarit ﷺ.

h) Larja e të gjithë pjesëve të cilat është obligim për ti larë

Pjesët që është obligim të lahen gjatë avdesit

Gjymtyrët që duhet larë gjatë avdesit janë gjashtë

a) Larja e fytyrës në tërësi

Allahu i Madhëruar thotë:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا قُمْتُمْ إِلَى الصَّلَاةِ فَاغْسِلُوا وُجُوهَكُمْ وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ

“O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja ...”.²

Duhet pasur parasysh se këtu bën pjesë edhe shpëlarja e gojës dhe hundës, sepse ato llogariten pjesë e fytyrës

b) Larja e duarve deri në bërryla, Allahu i Madhëruar thotë:

وَأَيْدِيَكُمْ إِلَى الْمَرَافِقِ **“..dhe duart tuaja deri në bërryla”.**³

c) Rënia mes’h kokës dhe veshëve, Allahu i Madhëruar thotë:

وَامْسَحُوا بِرُءُوسِكُمْ **“..fërkoni kokat tuaja..”**¹

¹Ahmedi 3/424, EbuDavud 175, Albani - Sahih

² El-Maide: 06

³ Maide: 6

Ndërsa i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Veshët janë pjesë e kokës*”².

Kur jemi tek mes’hu duhet përmendur se mes’h i bihet tërë kokës, e jo një pjesë të saj.

d) Larja e këmbëve deri në zogun e saj, Allahu i Madhëruar thotë:

وَأَرْجُلُكُمْ إِلَى الْكَعْبَيْنِ “*..e këmbët lani deri në dy zogjtë..*”³

Synetet e Avdesit

Ka disa vepra të cilat janë të pëlqyeshme të veprohen gjatë avdesit. Ai i cili i bën ato shpërblehet, ndërsa ai i cili i lë dhe nuk i vepron, nuk ka mëkat. Këto vepra quhen synetet e avdesit dhe ato janë:

a) Thënia Bismilah në fillim të avdesit.

Transmetohet nga i Dërguari ﷺ se ka thënë: “*Nuk ka avdes ai i cili nuk e përmend Allahun gjatë tij*”⁴

b) Përdorimi i misvakut.

Transmetohet se i Dërguari ﷺ ka thënë: “*Sikur mos ta rëndoja umetin tim, do t’i urdhëroja ta përdorin misvakun para çdo avdesi*”⁵

c) Larja e duarve tre herë në fillim të avdesit.

Kjo vepër është transmetuar nga i Dërguari ﷺ

d) Larja e mirë dhe e thellë e gojës dhe hundës, përveç atij i cili është duke agjëruar.

Siç është transmetuar nga i Dërguari ﷺ i cili ka thënë: “*Fute mire dhe thellë ujin në hundë, përveç nëse je duke agjëruar*”⁶.

e) Fërkimi i pjesëve që lahen dhe futja e gishtave në mjekër.

¹ Maide:6

² Tirmidhiu 37, IbnMaxhe 443, Albani - Sahih

³ Maide:6

⁴ Ahmedi 2/418, EbuDavudi 101, Hakimi 1/147

⁵ Buhariu

⁶ EbuDavud 142, Nesaiu 1/66 nr87, Albani - Sahih

Që nënkupton fërkimin e gjymtyrëve gjatë avdesit dhe depërtimin e ujit në mjekrën e madhe dhe të dendur.

Transmetohet nga i Dërguari ﷺ i cili: *“kur merrte avdes fërkonte krahët e tij”*.¹ Gjithashtu transmetohet se : *“I Dërguari ﷺ kur merrte avdes, merrte një grusht me ujë dhe e fuste në brendi të mjekrës dhe të njëjtën e fërkonte me ujë”*.²

f) Të dhënit përparësi të djathtës gjatë larjes së duarve dhe këmbëve.

Transmetohet se i Dërguari ﷺ: *“I pëlqente t’i jep përparësi të djathtës gjatë mbathjes së nallaneve të tij, gjatë krehjes së flokëve, gjatë pastrimit dhe në çdo veprim (të mirë)”*.³

g) Larja e fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tri herë.

Është e detyrueshme larja nga një herë ndërsa e pëlqyer tri herë. Transmetohet se i Dërguari ﷺ: *“Ka marrë avdes duke larë gjymtyrët një herë, duke i larë dy herë dhe duke i larë tre herë”*.⁴

h) Dhikri pas avdesit.

Transmetohet nga i Dërguari ﷺ i cili ka thënë: *“Secili prej jush që merr avdes dhe e plotëson atë ashtu siç duhet, pastaj thotë: “Eshhedu en la ilahe il-lall-llah vahdehu la sherike lehu ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu”, i hapen tetë dyer të xhenetit për të hyrë nga cila derë dëshiron.”*⁵

Ndërsa tek transmetimi që shënon Tirmidhiu gjejmë shtojcën: *“All-llahumme xha’lni minet-tevvabin vexhe’alni minel-mutetahirin.” (Allahu ynë, na bëj nga ata që pendohen dhe na bëj nga ata që pastrohen)”*⁶

¹IbnHiban 3/363 nr1082, Hakimi 1/243

²EbuDavud 145, Albani - Sahih

³Buhariu 168, Muslimi 226

⁴Buhariu 157, 158, 159, Muslimi 226

⁵Muslimi 234,

⁶Tirmidhiu 55, Albani - Sahih

Gjërat të cilat e prishin avdesin

Në gjuhën arabe quhen nevakid, që nënkupton gjërat të cilat e prishin dhe e bëjnë avdesin të pavlefshëm.

Të tillat janë gjashtë:

a) Çdo gjë që del nga dy organet e jashtëqitjes.

Ajo që del mund të jetë: urinë, jashtëqitje, menij (spermë), medhij (është lëngu i bardhë i hollë ngjitës i cili del gjatë epshit por jo fuqishëm), gjak, apo gazra, pa marrë parasysh a janë në sasi të vogël apo të madhe.

Allahu i Madhëruar thotë:

أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَائِطِ *“..ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës...”¹*

Ndërsa i Dërguari ﷺ thotë: *“Allahu nuk e pranon namazin tuaj nëse nuk merrni avdes, pasi ta keni prishur atë”*.² Gjithashtu në hadith tjetër thotë: *“...por nga jashtëqitja, urina dhe gjumi”*³

Në hadith tjetër i Dërguari ﷺ thotë: *“Mos ta ndërpresë (namazin) derisa të dëgjojë zërin apo nuhasë erën”*⁴

b) Dalja e ndyrësirave nga pjesët tjera të trupit.

Nëse ndyrësira është jashtëqitje apo urinë, atëherë avdesi priset dhe atë duke u argumentuar me argumentet e lartpërmendura. E nëse është diçka tjetër, si: vjellje, gjak, etj, nëse është me sasi të madhe është më mirë të merret avdes pas saj, e nëse është e paktë nuk e prish avdesin.

c) Humbja e vetëdijes, apo humbja e përkohshme e saj, me gjumë apo alivanosje.

Argument për këtë është fjala e të Dërguarit ﷺ: *“Syri është gjalmi (lidhësi) i qeses, ai që fle le të merr avdes”*.⁵

Çmenduria, alivanosja, të dehurit, apo të tjera sikur këto, e prishin avdesin me konsensus.

Ndërsa gjumi i cili e prish avdesin është gjumi i thellë në të cilin humbet tërë

¹ Maide:6

² Buhariu: 134

³ Ahmedi 4/239, Nesaiu 1/83, Tirmidhiu 96, Albani - Hasen

⁴ Buhariu 137, Muslimi 361

⁵ EbuDavud 203, IbnMaxhe 477, Albani - Hasen

vetëdija e njeriut, pa marrë parasysh në çfarë pozite e zë gjumi. Kurse, gjumi i lehtë në të cilin njeriu nuk thellohet, nuk e prish avdesin.

Kemi raste të shumta nga sahabet të cilët koteshin duke pritur namazin, pastaj u ngrinin për tu falur atë pa marrë avdes.¹

d) Prekja e organit pa leckë.

Transmeton Busra bint Safvan se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Kush e prek organin e tij le të marrë avdes.”*²

e) Ngrënia e mishit të devesë

Transmeton Xhabir Ibn Semure dhe thotë: *“Një njeri e pyeti të Dërguarin ﷺ: “A të marrim avdes nga të ngrënit e mishit të deles?” I Dërguari ﷺ tha: “Kush do, le të marrë avdes e kush do, le të mos marrë.” E ai pyeti sërish: “E a të marrim avdes nga të ngrënit e mishit të devesë?” I Dërguari ﷺ tha: “Po, merr avdes nga të ngrënit e mishit të devesë”.*³

Cështjet për të cilat është e obligueshme të merret avdes

Çdo besimtar i cili ka hyrë në moshën e pjekurisë është i obliguar të merr avdes për:

a) Namaz:

Thotë i Dërguari ﷺ: *“Allahu nuk pranon namazin e falur në gjendje papastërtie (xhunub ose pa avdes) dhe as lëmoshën e vjedhur”*⁴

b) Tavaf, pa marrë parasysh a është tavaf i obliguar apo vullnetar.

Thotë i Dërguari ﷺ: *“Tavafi është namaz, përveç se Allahu (subhanehu ue teala) e ka lejuar të folurit në të”*⁵.

Gjithashtu është transmetuar se i Dërguari ﷺ: *“Ka marrë avdes dhe pastaj ka bërë tavaf”*⁶.

Të njëjtën e vërteton rasti kur i Dërguari ndaloj gruan nga tavafi derisa të pastrohet nga cikli mujor”.¹

¹Muslimi 376

²EbuDavud 181, Nesaiu 163, Tirmidhiu 82, Albani - Sahih

³Muslimi 360

⁴Muslimi 224, Tirmidhiu 1

⁵IbnHiban 3836, Hakimi 1/459, Albani - Sahih

⁶Buhariu 1614, Muslimi 1235

c) Prekja e Mus'hafit pa leckë.

Allahu i Madhëruar thotë:

“ لا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ ” *“Atë nuk e prek kush, vetëm të pastrit”*.²

Ndërsa i Dërguari ﷺ thotë: *“Nuk e prek Mus'hafin vetëm se i pastërti.”*³

Çështjet për të cilat është e pëlqyeshme të merret avdes

Është e pëlqyeshme të merret avdes gjatë:

a) Leximit të Kuranit dhe përmendjes së Allahut.

b) Para çdo namazi, duke e ripërtëri atë.

Transmeton Enesi r.u. se i Dërguari ﷺ: *“Merrte avdes për secilin namaz”*.⁴

c) Personit i cili është xhunub dhe dëshiron ti vazhdojë kontaktet intime, apo nëse dëshiron të flejë, të hajë ose të pijë.

Transmeton Ebu Said ElKhudri r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Nëse dikush nga ju ka kontakt intim me gruan e tij dhe pastaj dëshiron të vazhdojë le të merr avdes”*⁵
Gjithashtu transmeton Aisha r.a. se: *“I Dërguari ﷺ kur dëshironte të flinte ndërsa ai ishte xhunub, merrte avdes ashtu siç merrte për namaz.”*⁶

Në një transmetim tjetër thuhet: *“Nëse dëshironte të hajë apo të flejë”*.⁷

d) Para nisjes së Guslit.

Transmeton Aisha r.a. se: *“I Dërguari i Allahut ﷺ kur pastrohej prej xhunubllëkut fillonte me pastrimin e duarve të tij. Pastaj merrte ujë me të djathtën e vendoste në të majtën dhe e pastronte organin e tij. Pastaj merrte avdes sikur që merrte për namaz. Pastaj merrte ujin dhe i fuste gishtërinjtë e tij në rrënjët e flokëve gjersa*

¹Buhariu 305, Muslimi 1211

²ElVakia: 79

³Maliku 1/199, DarKutni 1/121, Bejhakui 1/87

⁴Buhariu 214

⁵Muslimi 308

⁶Muslimi 305

⁷Buhariu 288

mendonte se ka arritur uji në rrënjët e tyre. Pastaj merre tre grushte ujë dhe hidhte mbi kokën e tij, pastaj përshkonte me ujë tërë trupin e tij”.¹

e) Para gjumit.

Transmeton Bera bin Azib r.u. se i Dërguari ﷺ ka thënë: “Kur të shkosh për të fjetur merr avdes ashtu siç merr për namaz dhe pastaj shtrihu në krahun e djathtë..”.²

¹Muslimi 316

²Buhariu 247

Kapitulli [VI] - Mes'hu mbi meste, imame (çallmë) dhe fashë (allçi)

Dispozita e mes'hut mbi meste dhe argumenti për të.

Mestet : janë mbathje nga lëkura apo materiale të tjera të ngjashme me të. Në gjuhën arabe quhet الخف (Khuf).

Dispozita e mes'hut:

Rënia mes'h mesteve është e lejuar me konsensus të Ehli Sunetit. Ky është një lehtësim nga Allahu i Madhëruar me qëllim që besimtarëve të ju sillen lehtësime dhe largohen vështirësitë.

Kemi transmetime të shumta nga i Dërguari ﷺ si nga praktika e tij, nxitje, si dhe lehtësim për përdorimin e tyre.

Thotë Imam Ahmedi: Nuk kam pikë dyshimi se mes'hu është i lejuar, janë transmetuar dyzet hadithe nga i Dërguari ﷺ për të.

Thotë Hasen ElBasri: Më kanë treguar shtatëdhjetë shokë të Dërguarit ﷺ se ai ka marrë mes'h mbi meste, e ndër ta hadithi i Xherir bin Abdullah r.u. i cili ka thënë: *"E kam parë të Dërguarin ﷺ i cili ka kryer nevojën dhe pastaj ka marrë mes'h mbi meste"*.¹ Transmeton E'ameshi nga Ibrahim i cili thotë: Sahabeve ju pëlqente ky hadith sepse Xheriri e ka pranuar Islam in pas zbritjes së sures ElMaide në të cilën gjendet citati i avdesit.

Dijetarët e Ehli Sunetit kanë rënë në ujdë se mes'hu është legjitim pa marrë parasysh a është në udhëtim apo në vendin e vet, dhe pa marrë parasysh a është rast nevojë apo jo.

Gjithashtu është i lejuar mes'hu mbi mbathje tjera të cilat i mbathin njerëzit dhe nuk janë nga lëkura, siç janë çorapet sepse ato janë sikur mestet në shërbimin e tyre për nevojat e njeriut, dhe arsyeja këtu është e njëjtë. Nëse ata mbulojnë këmbët atëherë lejohet përdorimi i tyre për mes'h.

¹ Muslimi 272, Buhariu 203

Kushtet e mes'hut mbi meste, apo mbathje të tjera të ngjashme

1. Veshja e tyre duke qenë me avdes.

Transmetohet se Mugire ibn Shu'be r.u. ka thënë: *“Një natë, derisa isha me të Dërguarin ﷺ në udhëtim, unë i qitja ujë për të marrë avdes, e ai lau fytyrën, duart deri në bërryl, fërkoj kokën e pastaj desha t'ia z bath mestet e tij, e ai ﷺ më tha: “Lëri, ngase unë i kam mbathur të pastra(me avdes)”, e pastaj mori mes'h mbi ta”*.¹

2. Mbathjet duhet ta mbulojnë zogun e këmbës, pjesën e cila është e obligueshme të lahet gjatë avdesit. E nëse nuk mbulojnë zogun e këmbës, nuk lejohet të përdoren për mes'h.

3. Të jen mestet e lejuara.

Nuk lejohet të merret mes'h mbi meste të vjedhura, të rrëmbyera, apo nga mëndafshi (për burrat), sepse veshja e tyre është mëkat dhe lehtësimet nuk lejohen me gjëra të ndaluara.

4. Të jenë mestet e pastra.

Nuk lejohet mes'hu mbi meste nëse janë të papastra, apo nëse janë nga ndonjë material i papastër, si p.sh: lëkura e dërrit, e qenit, gomarit, etj.

5. Të jetë mes'hu në limitin kohor të caktuar me Sheriat, e ajo është: për vendasin një ditë dhe një natë ndërsa për udhëtarin tri ditë dhe tri net.

Kushtet e lartpërmendura janë kushte të cilat dijetarët i kanë nxjerrë nga hadithet e të Dërguarit ﷺ dhe normat e përgjithshme të Sheriatit, prandaj ai i cili dëshiron të marrë mes'h duhet ti realizon këto kushte nëse dëshiron që mes'hu të jetë i pranuar.

¹ Buhariu 206, Muslimi 274

Mënyra e të marrit mes'h

Mes'h i jepet pjesës së dukshme të mesteve dhe kjo është kusht për pranimin e mes'hut.

Mënyra: Duhet rënë mes'h pjesës së sipërme të mesteve, siç ka ardhur në hadithin e Mugire bin Shu'be i cili e ka përshkruar mënyrën e të rënit mes'h tek i Dërguari ﷺ mbi mestet e tij pas avdesit, ku thotë: *“E kam parë të Dërguarin ﷺ duke marrë mes'h mbi meste, dhe atë në pjesën e dukshme të tyre”*.¹

Nuk është sunet e as nuk është i pranuar mes'hu në pjesën e poshtme të mesteve. Aliu thotë: *“Po të kishte qenë feja me logjikë, pjesa e poshtme e mesteve do të kishte qenë më me prioritet (për t'u dhënë mes'h) sesa pjesa e epërme, kurse unë e kam parë të Dërguarin ﷺ duke i dhënë pjesës së dukshme të mesteve (mes'h)”*.²

Nëse i bihet mes'h pjesës së epërme dhe asaj të poshtme, mes'hu është i pranuar por kjo mënyrë është e papëlqyer.

Kohëzgjatja e tij

Kohëzgjatja e mes'hut për vendasin është një ditë dhe një natë, ndërsa për udhëtarin tri ditë dhe tri net.

Aliu r.u. thotë: *“I Dërguari ﷺ caktoi tri ditë e tri net për udhëtarin, kurse një ditë e një natë për vendasin.”*³

Gjërat të cilat prishin mes'hun

a) Nëse na ndodh diç që na e obligon Guslin.

Safvan bin Asal ka thënë: *“Kur ishim në udhëtim i Dërguari ﷺ na urdhëronte të mos i heqim mestet tri ditë dhe tri net përveç në raste të xhunubllëkut”*.⁴

b) Nëse zbulohet një pjesë e cila është obligim për tu mbuluar.

c) Heqja e mesteve, njëerës apo dyjave.

d) Përfundimi i kohës së mes'hut.

¹Tirmidhiu 98, Albani - Hasen

²EbuDavud 162, Bejhaki 1/292

³Muslimi 85

⁴Ahmedi 4/239, Nesaiu 1/84, Tirmidhiu 96, Albani - Hasen

Fillimi i kohës së mes’hut

Fillimi i llogaritjes së kohës së mes’hut bëhet nga momenti kur atyre iu bihet mes’h, sepse nga atëherë fillon përdorimi i tyre.

Mes’hu mbi fashë, imame apo shami të grave

- Me fashë këtu nënkuptojmë allçinë, apo materiale të tjera siç është: leshi, pambuku, fashat mjekësore, të cilat vendohen në këmbë për shkaqe të ndryshme, siç janë: thyerja, kurimi i varrës apo shkaqe tjera.

Mes’hu mbi ta është i lejuar përderisa ata janë të nevojshme për njeriun, dhe në atë moment kur përfundon nevoja, përfundon edhe lejimi i mes’hut.

Mes’hu mbi të lartpërmendurat lejohet si në rastin kur njeriu ka humbur avdesin ashtu edhe në atë rast kur humb edhe guslin, dhe atë duke mos pasur një kohë të caktuar të kohëzgjatjes së mes’hut.

Pra, lejohet mes’hu deri në momentin kur të hiqet fasha dhe të përfundon nevoja për të, edhe nëse ajo zgjat me ditë apo muaj. Argument për këtë është fakti se përdorimi i kësaj është domosdoshmëri e njeriut, ndërsa në islam e kemi një rregull: *Edarure tukaderu bikaderiha, që d.m.th. Domosdoshmëria vlerësohet në bazë të gjendjes reale të saj.*

- Gjithashtu lejohet mes’hu mbi Imame (Çallmë), e ajo është material i gjatë i cili rrethon kokën dhe e mbulon atë.

Transmeton Mugira bin Sh’ube se i Dërguari ﷺ: “*Ka marrë mes’h mbi imame, mbi pjesën e parme të kokës dhe mbi meste*”.¹

Gjithashtu transmetohet se i Dërguari ﷺ: “*Ka marrë mes’h mbi meste dhe mbi khimar*”², e që ka për qëllim imamen.

Mesti mbi imame nuk ka ndonjë kohë të caktuar, por sikur ta zgjidhte atë më të sigurtën, pra të veprojë njëlloj sikur mestet do ishte më mirë.

- Ndërsa sa i përket shamisë së grave, dhe ajo është pëlhura me të cilën ajo mbulon kokën, e ka të njëjtën dispozitë sikur imamja (çallma) tek burrat, andaj edhe është e lejuar ti bihet mes’h.

¹Muslimi 274

²Muslimi 275

Kapitulli [VII] - Gusli

Përkufizimi gjuhësor: fjala “*Gusl*”: rrjedh nga folja gasale-jegsilu e cila nënkupton larjen e tërë trupit.

Përkufizimi terminologjik: përshkimi i tërë trupit me ujë pastrues në mënyrë të veçantë dhe me qëllim të adhurimit të Allahut të Madhëruar.

Dispozita e tij:

Gusli është i obliguar nëse ka shkak që e bënë atë të obliguar. Allahu i Madhëruar thotë:

وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا “Nëse jeni *xhunub* (të papastër), pastrohuni (merrni *gusl*).”¹

Gjithashtu janë transmetuar hadithe të shumta nga i Dërguari ﷺ dhe atë nga një numër i konsiderueshëm i sahabeve, ku përshkruhet mënyra e marrjes së *guslit* dhe të njëjtat aludojnë në obligueshmërinë e tij.

Gjërat që obligojnë *Guslin*

a) Ejakulimi gjatë gjumit apo në gjendje të zgjuar, qoftë nga mashkulli apo nga femra.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَإِنْ كُنْتُمْ جُنُبًا فَاطَّهَّرُوا “Nëse jeni *xhunub*, pastrohuni.”²

Ndërsa i Dërguari ﷺ ka thënë: “Nëse e hedh ujin fuqishëm atëherë duhet marrë *gusul*”.³

Nëse njeriu është në gjumë atëherë epshi nuk është kusht, sepse mund të ndodh që njeriu të mos e ndjejë atë.

Argument për këtë është hadithi i Ummu Seleme r.a. e cila tregon se Ummu Sulejm r.a. ka thënë: “O i Dërguar i Allahut, me të vërtetë Allahu nuk turpërohet prej së

¹ Maide: 6

² Maide: 6

³ EbuDavudi 206, Albani - Sahih

vërtetës. A thua vallë gruaja duhet larë kur të ëndërrojë?” I Dërguari ﷺ tha: “Po, nëse sheh ujë (gjurmë)”¹

Dhe për të gjithë këtë që përmendëm ka konsensus të dijetarëve.

b) Depërtimi i organit mashkullor pjesërisht apo tërësisht në atë femëror, edhe nëse nuk ndodh ejakulim.

Ebu Hurejra r.u. thotë se i Dërguari ﷺ ka thënë: *“Kur të ulet burri në mes katër gjymtyrëve të gruas dhe takohen dy synetimet, obligohet larja.”*² Duhet pasur parasysh se kjo nuk vlen për fëmijët nën moshën e pjekurisë.

c) Pranimi i Islamit nga mosbesimtari, apo felëshuesi.

“I Dërguari ﷺ e urdhëroi Kajs bin Asim r.u. të merr gusul kur ai e pranoi Islamit”³

d) Ndërprerja e gjakut të ciklit mujor dhe lehonisë

Aishja r.a. thotë: *“I Dërguari ﷺ i ka thënë bijës së Hubejshit: “Kur të vijë cikli mujor, lëre namazin e kur të dalësh nga ajo gjendje, lahu dhe vazhdo faljen.”*⁴ Lehonja ka të njëjtin gjykim sikur cikli dhe atë me konsensus të dijetarëve.

e) Vdekja

Dijetarët kanë thënë se kur njeriu vdes, para varrimit është obligim të pastrohet, duke u bazuar në atë se: *Kur vdiq Zejnebi r.a., vajza e të Dërguarit ﷺ, ai i urdhëroi disa gra që ti japin gusul, ta pastrojnë atë tre, pesë, apo shtatë here.*⁵ Gjithashtu i urdhëroi shokët e tij ta pastrojnë personin i cili kishte vdekur në haxh duke thënë: *“Lajeni me ujë dhe sidër”*.⁶

¹Muslimi 313

²Muslimi 349

³EbuDavud 3ç, Nesaiu 1/109, Tirmidhiu 605, Albani – Sahih

⁴Buhariu 320, Muslimi 333

⁵Buhariu 1253, Muslimi 939

⁶Buhariu 1266, Muslimi 1206

Mënyra e marrjes gusul

Gusli posedon dy mënyra të marrjes së tij: Mënyrën e pëlqyeshme dhe atë të mjaftueshme.

- **Mënyra e pëlqyer:** Të jetë vepra e shoqëruar me nijet dhe të fillohet me larjen e duarve, pastaj larjen e organit dhe pjesëve tjera të trupit në të cilat ka papastërti, pastaj merr avdes sikurse merr për namaz, pastaj merr ujë dhe shpërlanë me të kokën duke i shtirë gishtërinjtë në rrënjët e flokëve derisa të laget lëkura e kokës. Pastaj hedh ujë mbi kokë tre herë dhe hedh ujë mbi tërë trupin.

Thotë Mejmuneh r.a.: *“Unë i dhashë ujë të Dërguarit të Allahut ﷺ që ai të merrte Gusël me të. Ai lau duart dy apo tre herë dhe pastaj hodhi ujë nga dora e djathtë tek ajo e majta dhe lau pjesët intime. Më pas, i fshiu duart përtokë, shpëlau gojën dhe hundën, lau fytyrën dhe duart, fërkoi kokën tre herë, pastaj hodhi ujë mbi trupin e tij e në fund lëvizti nga vendi dhe lau këmbët. Unë i çova një peshqir, por ai nuk e mori, sepse kishte dëshirë ta fshijë ujin me duart e tij”*.¹

Gjithashtu është transmetuar nga Aishja: *“Kur i Dërguari ﷺ hynte për tu pastruar, pas kryerjes së marrëdhënieve intime, ai fillonte me larjen e duarve. Pastaj, me dorën e tij të djathtë hidhte ujë mbi të majtën dhe lante organin e tij gjenital, merrte avdes si për namaz, merrte pak ujë dhe i vendoste gishtërinjtë e tij në rrënjët e flokëve, derisa e shihte se lëkura lagej, më pas hidhte ujë mbi kokën e tij tre herë dhe pastaj mbi pjesën tjetër të trupit”*²

- **Mënyra e mjaftueshme:** të jetë vepra e shoqëruar me nijet dhe të përshkohet i tërë trupi me ujë.

Nuk është e obliguar që gruaja ti lëshon gërshetat e saj kur pastrohet nga xhunubllëku, ndërsa nga pastrimi pas ciklit mujor dhe lehonisë po.

Transmeton UmuSeleme r.a. se e ka pyetur të Dërguarin ﷺ: *“O i Dërguar i Allahut! Unë i kam të lidhur flokët gërsheta. A duhet t’i lëshoj ato kur marr gusël, pas kryerjes së marrëdhënieve intime?”* Ai i është përgjigjur: *“Jo, është e mjaftueshme për ty që të hedhësh tre grushte ujë mbi kokë dhe pastaj të hedhësh ujë mbi të gjithë trupin. Pasi ta kesh bërë këtë, ti je pastruar”*.³

¹ Buhariu 249, Muslimi 317

² Buhariu 248, Muslimi 316

³ Muslimi 330

Rastet kur gusli është i preferuar

Më herët përmendëm rastet kur gusli është i obligueshëm, ndërsa tani do përmendim rastet kur gusli është i preferuar dhe i pëlqyer:

a) Larja pas çdo kontakti intim

Ebu Rafiu transmeton se një natë i Dërguari ﷺ i vizitoi të gjitha gratë e tij dhe lahej pas çdo akti. I thashë: “O i Dërguar i Allahut, përse nuk lahesh në fund një herë?” Ai ﷺ tha: “Kështu është më mirë dhe më pastër”.¹

b) Larja në ditën e Xhuma

Thotë i Dërguari ﷺ: “Kush dëshiron të vijë në xhuma le të pastrohet”²

c) Larja para ihramit për haxh apo umre

Transmetohet se i Dërguari ﷺ para se ka veshur ihramin është pastruar.

d) Larja për bajram

Kjo është prej veprës së të parëve tanë të mirë (selefëve): Aliu, Ibn Omeri, Esh-Sha’bij, Ata, Katadeh, Shafii, Alkameh, Urveh dhe En-Nekhai, Malik, etj.

e) Larja e atij i cili e lanë të vdekurin

I Dërguari ﷺ thotë: “Kush e lanë xhenazen, le të lahet”³.

Disa norma që vlejné për personin të cilit i është obliguar gusli

a) Nuk i lejohet atij të qëndrojë në xhami vetëm se si kalimtarë,

Allahu i Madhëruar thotë:

“ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَقْرُبُوا الصَّلَاةَ وَأَنْتُمْ سُكَارَىٰ حَتَّىٰ تَعْلَمُوا مَا تَقُولُونَ وَلَا جُنُبًا إِلَّا عَابِرِي سَبِيلٍ حَتَّىٰ تَغْتَسِلُوا ”

“O ju që besuat! Mos iu afroni namazit duke qenë të dehur, derisa të dini se ç’flitni e as duke qenë xhunub, derisa të laheni,”⁴

E nëse merr avdes duke qenë xhunub atëherë i lejohet atij të qëndron në xhami, siç është transmetuar nga një numër i konsiderueshëm i sahabëve, sepse avdesi e zvogëlon papastërtinë e xhunubllëkut.

¹ EbuDavudi 216, IbnMaxhe 590, Albani-Hasen

² Buhariu 877

³ IbnMaxhe 1463, Albani - Sahih

⁴ En-Nisa: 43

b) Nuk i lejohet atij të prek Kuranin

Allahu i Madhëruar thotë:

“لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ” *“Atë nuk e prek kush, vetëm të pastrit”*.¹

Gjithashtu i Dërguari ka thënë: *“Nuk e prek Kuranin vetëm se i pastrit”*.²

c) Nuk i lejohet atij leximi i Kuranit

Pra njeriu i cili është xhunub nuk lexon Kuran derisa të pastrohet.

Transmeton Aliu se: *“Të Dërguarin ﷺ nuk e ndalonte asgjë nga leximi i Kuranit vetëm se xhunubllëku”*.³

Ndalimi i tillë është edhe nxitës për një pastrim sa më të shpejtë, me ç’rast do largohet pengesa e cila ndalon leximin.

d) Nuk i lejohet namazi**e) Nuk i lejohet tavafi**

Siç e kemi cekur në kaptinën e pestë se çdo adhurim për të cilin është kusht avdesi është kusht edhe gusli.

¹ El-Vakia: 79

²Maliku në Muvata 1014, IbnMaxhe 594, Tirmidhiu 146

³Imam Ahmedi 1014, IbnMaxhe 594, Tirmidhiu 146

Kapitulli [VIII] - Tejemmumi

Përkufizimi gjuhësor: *Fjala tejemmum do të thotë qëllim ose mësymje për të vepruar diçka.*

Përkufizimi terminologjik: *Tejemmumi është fërkimi i fytyrës dhe duarve me dhe (truall) të pastër, në formë të caktuar në rast të pamundësisë së përdorimit të ujit, me qëllim të adhurimit të Allahut.*

Dispozita e tejemmunit dhe argumentet e ligjshmërisë së tij

Tejemmumi në shariatit islam është legjitim dhe është lehtësim nga Allahu i Madhëruar për robërit e Tij.

Ky ndër tjerash është lehtësim si dhe veçori e umetit të Dërguarit ﷺ.

Allahu i Madhëruar thotë:

وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَائِطِ أَوْ لَامَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ يَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا
بِأَيْدِيكُمْ وَأَيْدِيكُمْ

“... Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen pas kryerjes së nevojës, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyni dheun e pastër (merrni tejemmum) dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja.”¹

Ndërsa i Dërguari ﷺ thotë: *“Dheu i pastër është pastrim për besimtarin, edhe nëse nuk gjen ujë dhjetë vite”²*

Gjithashtu i Dërguari ﷺ thotë: *“.. më është bërë e tërë toka vend falje dhe pastrim (tahur)”³*

Dijetarët kanë rënë ujdi për ligjshmërinë e tejemmunit dhe lejimin e përdorimit të tij nëse plotësohen kushtet, dhe se ai është zëvendësues i ujit, lejohet me të çdo gjë që lejohet pas pastrimit me ujë, siç janë: namazi, tavafi, leximi i Kuranit, etj. Prandaj themi: Tejemmumi është legjitim me Kuran, Sunet dhe ixhma (konsensus).

¹ ElMaide:6

² EbuDavudi 329, Tirmidhiu 124, Albani - Sahih

³ Buhariu 335

Kushtet e Tejmmumit dhe shkaqet e lejueshmërisë së tij

Siç u cek, tejmumimi është i lejuar gjatë pamundësisë së përdorimit të ujit, si nga mungesa e tij apo nga frika se përdorimi i tij mund të na dëmtojë, si shkak i ndonjë sëmundjeje trupore apo ftohtit të madh.

Transmeton Imran bin Husejn r.u. se i Dërguari ﷺ pa një burrë që rrinte vetëm, i cili nuk u fal me njerëzit dhe i tha: *O filan! Ç'të pengoi të faleshe me njerëzit? Ai tha: O i Dërguari i Allahut! Unë isha xhunub, dhe nuk kishte ujë. I Dërguari ﷺ i thotë: “Atëherë mësyja vendit (dheut) të ngritur nga toka, sepse ai të mjafton”.*¹

Kushtet që tejmumimi të jetë valid:

- a) Nijeti: Ashtu sikur në të gjitha adhurimet tjera edhe në tejmumim nijeti është kusht i pranimit të këtij adhurimi.
- b) Islami: Nuk pranohet nga mosbesimtari sepse tejmumimi është adhurim.
- c) Mendja: Nuk pranohet nga i çmenduri e as i alivanosuri.
- d) Dallimi: Nuk pranohet nga fëmija i cili është ndër moshën e dallimit (shtatë vjeçare).
- e) Pamundësia e përdorimit të ujit:

Allahu i Madhëruar thotë:

“فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا”

*“..dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyni dheun e pastër (merrni tejmum)..”.*²

Ndërsa i Dërguari ﷺ thotë: *“Dheu i pastër është pastrim për besimtarin, edhe nëse nuk gjen ujë dhjetë vjet, e nëse gjen ujë le ta fërkojë me të lëkurën e tij pasi kjo është më e mirë”.*³

- Pamundësia mund të jetë nga dëmi që mund të sjell përdorimi i ujit, sëmundja, shtimi i sëmundjes, parandalimi i shërimit etj.

¹ Buhariu 344, Muslimi 682

² Maide: 6

³Tirmidhiu 124

Allahu i Madhëruar thotë:

وَإِنْ كُنْتُمْ مَرْضَىٰ أَوْ عَلَىٰ سَفَرٍ أَوْ جَاءَ أَحَدٌ مِّنْكُمْ مِنَ الْغَائِطِ أَوْ لَامَسْتُمُ النِّسَاءَ فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ

“... Në qoftë se jeni të sëmurë, ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vjen prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyni dheun e pastër (merrni tejemmum) dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja.”¹

Xhabiri, r.u. tregon: “Patëm dalë në udhëtim, e njërin prej nesh e pat goditur një gurë në kokë dhe u plagos. E gjatë natës u bë xhunub dhe i pyeti shokët e tij: “A më lejohet të marr tejemmum?” I thanë: “Jo, nuk të lejohet, pasi ke ujë”. Atëherë ai u la dhe vdiq. E kur erdhën tek i Dërguari ﷺ, ne ia treguam këtë rast, e ai tha: “E vranë, i vraftë Allahu. Përse nuk kanë pyetur, pasi s’kanë ditur, sepse vërtetë shërimi i paditurisë është pyetja. Do t’i mjaftonte sikur të merrte tejemmum”.²

● Gjithashtu pamundësi mund të llogaritet edhe frika nga dëmi i përdorimit të ujit. Amër ibn Asi r.u. u dërgua në betejën Dhatu-Selasil e tha: “Një natë të ftohtë, pashë ëndërr dhe u bëra xhunub, pata frikë të lahem, se mos sëmuresha, por mora tejemmum dhe dola imam në namazin e sabahut. E kur erdhëm te i Dërguari ﷺ, sahabët ia treguan këtë rast. Ai tha: “O Amër, a je falur imam duke qenë xhunub?” Iu përgjigja: “...dhe mos mbytni veten tuaj. Vërtet, Allahu është i Mëshirshëm për ju.”³ Morra tejemmum e u fala. I Dërguari ﷺ qeshi e nuk tha asgjë.”⁴

f) Të merret tejemmum me dhe të pastër i cili ka pluhur që ngjitet për dore. Allahu i Madhëruar thotë:

“فَلَمْ تَجِدُوا مَاءً فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا”

“..dhe nuk gjeni ujë, atëherë mësyni dheun e pastër (merrni tejemmum)..”⁵

Thotë Abdullah bin Abas r.u.: *Saiid*: është për qëllim dheu pasi që të lëvrohet toka (fytyra, sipërfaqja e tokës), ndërsa *Tajib*: i mirë, i pastër.

¹ ElMaide: 6

² EbuDavudi 337, IbnMaxhe 572

³ En-Nisa: 29

⁴ Ahmed 203/4, EbuDavud 334

⁵ Maide:6

Nëse nuk gjen dhe atëherë lejohet të merr tejmum me çka të ketë mundësi, si gurë, rërë dhe atë duke u argumentuar me fjalën e Allahut:

فَاتَّقُوا اللَّهَ مَا اسْتَطَعْتُمْ **“Keni frikë Allahun sa të keni mundësi”**.¹

Gjithashtu Euzai thotë: Rëra është sikur dheu.

Gjërat që prishin tejmumin

1. Tejmumi priset nga gjërat që prishin avdesin dhe nga ato të cilat priset gusli, sepse tejmumi është zëvendësues dhe zëvendësuesi priset me të njëjtën që priset origjina (i zëvendësuar).
2. Prania e ujit: Nëse tejmumi është marrë si shkak i mungesës së ujit, vetë prania e ujit e bën tejmumin të pavlefshëm, dhe atë duke u argumentuar me fjalën e të Dërguarit ﷺ: “...edhe nëse nuk gjen ujë dhjetë vjet, dhe nëse gjen ujë le ta fërkojë me të lëkurën e tij...”
3. Largimi i arsyes për të cilën është marrë tejmum, sikur që janë: frika, sëmundja, etj..

Forma e marrjes tejmum

Tejmumi merret në këtë formë: Së pari e bën nijet, thuhet “Bismil-lah”, godit tokën me shuplakat e tij një herë, pastaj i frynë ose i shkund për ta hekur dheun e tepërt, pastaj me shuplaka fërkon fytyrën dhe duart deri në nyje (te byzylykët). Argument për këtë: Ajeti Kuranor:

فَامْسَحُوا بِوُجُوهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ **“...dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja.”**

Nëse duart në Kuran përmenden të papërcaktuara, atëherë janë për qëllim vetëm deri në nyje. Dëshmi për këtë është rasti ku Allahu i Lartësuar urdhëron që hajnit t'i pritët dora, ka ardhur e përgjithshme dhe e papërcaktuar.

Allahu i Lartësuar thotë:

وَالسَّارِقُ وَالسَّارِقَةُ فَاقْطَعُوا أَيْدِيَهُمَا **“...vjedhësit dhe vjedhëses prejani duart e tyre.”**²

¹ Tegabun:6

² ElMaide:38

Gjithashtu hadith i Amarit r.u. në të cilin thuhet: *“Tejemmumi është fërkim i fytyrës dhe i shuplakave”*.¹

Amar Ibn Jasiri r.u. thotë: “U bëra xhunub e nuk u lava, por u shtriva në tokë, u rrokullisa dhe u fala. Këtë ia përmenda të Dërguarit ﷺ e ai më tha: *“Do të mjaftonte kjo.” I Dërguari ﷺ i ra tokës me duar, fryu në to, pastaj fërkoi me to fytyrën dhe shuplakat*”.²

¹ Ahmedi 4/263, EbuDavud: 327, Albani - Sahih

² Buhariu 347, Muslimi 368

Kapitulli [IX] - Ndyrësirat dhe mënyra e pastrimit nga to

Ndyrësira: është çdo papastërti nga e cila na ka urdhëruar Ligjvënësi të largohemi.

Ajo është dy lloje:

1. Ndyrësirë reale: Kjo nuk ka mundësi të bëhet e pastër asnjëherë sepse ajo në vetveten e saj është e papastër, sikur që është: bajga e gomarit, derri, urina, etj.

2. Ndyrësirë normative: Është veti e cila konsiderohet e papastër dhe si e tillë i mvishet gjymtyrëve të njeriut, me ç'rast i pamundëson kryerjen e adhurimeve siç janë: namazi, tavafi, etj.

Kjo papastërti nënkupton papastërtinë e vogël e cila largohet me avdes dhe papastërtinë e madhe e cila largohet me gusul.

Në esencë ndyrësirat largohen me ujë, pra uji është esenca e pastërtisë.

Allahu i Madhëruar thotë:

"وَيُنَزِّلُ عَلَيْكُمْ مِّنَ السَّمَاءِ مَاءً لِّيُطَهِّرَكُم بِهِ" *".. ju lëshoi shi nga qielli për t'ju pastruar me të.."*¹

Ndyrësirat sipas nivelit të ndyrësirës janë tri lloje:

a) Ndyrësirë e rëndë: Ndyrësira e qenit.

b) Ndyrësirë e lehtë: Ndyrësira e urinës së foshnjës mashkull i cili nuk ka filluar të ushqehet.

c) Ndyrësirë e mesme: Këtu hyjnë ndyrësirat tjera, sikurse: Urina, jashtëqitja, cofëtinat, etj.

Gjërat për të cilat kanë ardhur argumente që vërtetojnë ndyrësinë e tyre

1. Vjellja, Urina dhe jashtëqitja e njeriut:

Këtu përjashtohet urina e foshnjës mashkull i cili nuk ka ngrënë ushqim, për pastrimin e së cilës mjafton vetëm spërkatja me ujë.

Një gjë e tillë bazohet në hadithin e Umu Kajs e cila tregon se: *"Njëherë shkoi tek i Dërguari i Allahut ﷺ me djalin e saj që ushqehet me gjë. Ndërsa po e mbante, ai urinoi në prehrin e të Dërguarit ﷺ. Ai kërkoi pak ujë dhe i spërkati rrobat e tij dhe nuk i lau ato".*²

Ndërsa urina e foshnjës mashkull i cili ka filluar të ushqehet, dhe urina e foshnjës femër lahet sikurse urina e të rriturit.

¹ Enfal: 11

² Buhariu:223

2. Gjaku i derdhur gjatë therjes së kafshës ushqimi i të cilave hahet, ndërsa gjaku i cili mbet në damarë dhe në mish, ai është i pastër.

Allahu i Madhëruar thotë:

"قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً أَوْ دَمًا مَسْفُوحًا أَوْ حَمَّ خَنِزِيرٍ فَإِنَّهُ رِجْسٌ"
"Thuaj: "Në atë që më është shpallur mua nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai është: cofëtinë, gjak i derdhur ose mish derri, ai është i ndytë.."¹

3. Urina dhe bajga e çdo kafshe mishi i së cilës nuk hahet.

4. Ngordhësira: Këtu bëhet fjalë për kafshën e cila ka ngordhur apo nuk është therur sipas Sheriatit. Allahu i Madhëruar thotë:

"قُلْ لَا أَجِدُ فِي مَا أُوحِيَ إِلَيَّ مُحَرَّمًا عَلَى طَاعِمٍ يَطْعَمُهُ إِلَّا أَنْ يَكُونَ مَيْتَةً"

"Thuaj: "Në atë që më është shpallur mua nuk po gjej të ndaluar diçka nga ushqimi, përveç në qoftë se ai është: cofëtinë..."²

Këtu nuk bën pjesë peshku, karkalecat dhe ngordhësirat që nuk kanë gjak të rrjedhshëm, këta janë të pastra.

5. El-Medhij: Quhet lëngu (sekrecioni) i bardhë i cili zgjatet dhe është ngjitës, që rrjedh nga organet intime si rezultat i të menduarit ose ngacmimit seksual. Ky sekrecion mund të rrjedhë nga dy gjinitë.

Aliu tregon: "Unë kisha sekretim të el-medhiut, kështu që i kërkova një burri që ta pyeste të Dërguarin ﷺ në lidhje me këtë. Mua më vinte turp ta pyesja për arsye të pozitës sime dhe respektit që kisha për vajzën e tij. Ai ﷺ u përgjigj: *"Merr avdes dhe laje organin"*.³

Kurse për pastrimin e rrobave nga ky lëng tregon Sehl bin Hunejf r.u. se i Dërguari ﷺ e porositi atë duke i thënë: *"Është e mjaftueshme të marrësh një grusht ujë dhe të spërkatësh rrobat e tua në të gjitha vendet ku është përhapur lëngu"*⁴

6. El-Vedij: Është një lëng i bardhë dhe i trashë që del zakonisht pas urinimit tek disa njerëz. Ky lëng gjithashtu është i papastër.

¹ El-En'am: 145

² El-En'am: 145

³ Buhariu:269

⁴ Buhariu

Për këtë Aishja r.a. thotë: "El-Vedij rrjedh pas urinimit. Njeriu i cili ka këtë rrjedhje duhet të lajë pjesët intime, pastaj të marrë avdes dhe nuk ka nevojë të marrë gusël."¹

7. Gjaku i ciklit mujor:

Gjaku i ciklit mujor konsiderohet i ndyrë, prandaj nëse bie në rroba, duhet të pastrohet me ujë.

Transmeton Esma r.a. e bija e Ebu Bekrit, r.u. e cila thotë: Një grua erdh tek i Dërguari ﷺ dhe i tha: “Ndodh që një rës prej nesh i bie gjaku i ciklit mujor në rroba, si të veprojmë?” I Dërguari ﷺ tha: “E gërryen, pastaj e lan me ujë, e pastaj falesh”.²

Mënyra e pastrimit të ndyrësirave

1. Nëse ndyrësira është në tokë apo në ndonjë vend të ngjashëm:

Për ta pastruar atë mjafton vetëm një shpëlarje e cila do ta largon ndyrësirën. Pra, hedh ujë mbi të dhe kjo është e mjaftueshme. “Kështu urdhëroi i Dërguari ﷺ shokët e tij të hedhin ujë mbi vendin ku urinoi beduini në xhami”.³

2. Nëse ndyrësira nuk është në tokë, por është në rrobë apo në enë.

Këtu kemi të bëjmë me disa lloje:

a) Nëse është jargë qeni i cili ka lëpirë enën, atëherë duhet pastruar shtatë herë, prej të cilave njëra duhet të jetë me dhe. Thotë i Dërguari ﷺ: “Nëse qeni ka lëpirë ndonjë nga enët tuaja, lajeni atë shtatë herë dhe larjen e parë bëjeni me dhe”.⁴

Kjo dispozitë është e përgjithshme dhe vlen si për enën ashtu edhe për rrobat, shtrojat, etj.

b) Nëse është ndyrësirë nga derri, ajo është sikur ndyrësirat tjera dhe pastrohet vetëm me një shpëlarje derisa ndyrësira të largohet dhe nuk është kusht të lahet shtatë herë.

c) Ndyrësirat tjera siç janë: urina, jashtëqitja, gjaku, këta shpërlahen me ujë dhe atë duke e fërkuar dhe shtrydhur mirë, me qëllim që të largohen të gjitha gjurmët e papastërtisë. Edhe për këtë është e mjaftueshme një shpëlarje nëse ajo largon ndyrësirën.

¹IbnMundhir, Ibn EbiShejbe

²Buhariu 227, Muslimi 291

³Buhariu:220, Muslimi:284

⁴Muslimi:279,

- d)** Urina e foshnjës mashkull që nuk ka filluar të hajë ushqim, bëhet vetëm me stërpikje me ujë. Thotë i Dërguari ﷺ: *”Urina e foshnjës mashkull duhet të spërkatet me ujë, kurse urina e foshnjës femër duhet larë”*.¹
- e)** Lëkura e cofëtinës mishi i të cilës hahet, pastrohet me regje siç e kemi cekur më herët, dhe atë duke u argumentuar me fjalën e të Dërguarit ﷺ: *”Secila lëkurë që është regjur është pastruar”*.²

Besimtari duhet të jetë i kujdesshëm që të pastrojë veten, vendin ku kryen adhurimet dhe rrobat e tij nga ndyrësit, sepse pastërtia është nga kushtet e pranimit të namazit.

¹ EbuDavudi:376, Nesaiu:303, IbënMaxhe:526. Albani e ka cilësuar sahih.

² Nesaiu:4252, Tirmidhiu:1728, IbnMaxhe:3609, Albani e ka cilësuar sahih.

Kapitulli [IX] - Cikli mujor dhe Lehonja

Cikli mujor:

Përkufizimi gjuhësor: *Të rrjedhurit ose të kulluarit.*

Përkufizimi terminologjik: *Është një gjak i cili rrjedh nga mitra e femrës çdo muaj, nga koha kur ajo arrin moshën e pjekurisë.*

Lehonja (Nifasi)

Përkufizimi gjuhësor: *Lindje.*

Përkufizimi terminologjik: *Është gjak i cili rrjedh nga mitra e gruas për shkak të lindjes.*

Koha e fillimit dhe përfundimit të ciklit mujor

Nuk ka cikël mujor para moshës nëntë vjeçare, sepse zakonisht nuk ndodh një gjë e tillë. Transmetohet se Aisha r.a. ka thënë: “Kur vajza i mbushë nëntë vjet, ajo më është grua.”¹

Ndërsa pas moshës pesëdhjetë vjeçare, në shumicën e rasteve, cikli mujor përfundon. Aisha r.a. ka thënë: Nëse gruaja arrin moshën pesëdhjetë vjeçare del nga periudha e ciklit mujor.”²

Koha më e shkurtër dhe më e gjata e ciklit mujor

E vërteta është se nuk ka përkufizim të kohëzgjatjes të ciklit mujor, por kjo gjë caktohet në bazë të zakonit së gruas.

Kohëzgjatja e shumicës së ciklit

Tek shumica e grave kohëzgjatja e ciklit mujor është gjashtë apo shtatë ditë. I Dërguari ﷺ i është drejtuar Hamne bint Xhahshit r.a. duke i thënë: “ *Me të vërtetë*

¹Tirmidhiu: 3/418, Bejhekiu: 1/320

²ElMugni 1/406

ajo është përpjekje e shejtanit për të mashtruar. Llogariti gjashtë apo shtatë ditë të ciklit mujor pastaj pastrohu dhe falu njëzetekatër apo njëzetetë ditë siç veprojnë shumica e grave”.¹

Çka bëhet e ndaluar si shkak i ciklit mujor dhe Lehonisë

Si shkak i ciklit mujor dhe lehonisë ndalohen disa çështje, e ato janë:

1. Kontaktet intime: Allahu i Madhëruar thotë:

" وَيَسْأَلُونَكَ عَنِ الْمَحِيضِ ۖ قُلْ هُوَ أَذَىٰ فَاعْتَزِلُوا مِنَ النِّسَاءِ فِي الْمَحِيضِ "

“Të pyesin ty për ciklin mujor. Thuaj: Ajo është një gjendje e neveritur, kështu që largojuni atyre (mos kryeni marrëdhënie intime) derisa të pastrohen...”.²
 Pas zbritjes së këtij ajeti i Dërguari ﷺ tha: *“Mund të bëni çdo gjë përveç marrëdhënies intime”.*³

2. Divorci:Allahu i Madhëruar thotë:

" يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِذَا طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ فَطَلَّقُوهُنَّ لِعَدَّتِهِنَّ "

*“O ti Pejgamber, kur t'i lëshoni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë së tyre)..”.*⁴

Gjithashtu argument është rasti ku tregohet se i Dërguari ﷺ i është drejtuar Omerit r.u. pasi që djali i tij Abdullahu r.u. e kishte bërë divorc gruan e tij në kohën e të përmuajshmeve, duke i thënë: *“Urdhëroje le ta kthejë përsëri”.*⁵

3. Namazi: I Dërguari ﷺ iu drejtua Fatime bint Ebi Hubejsh r.a. duke i thënë: *“Nëse të vjen cikli mujor lëre namazin, e kur të mbarojë pastrohu dhe falu”.*⁶

4. Agjërimi: Ebu Seidi r.u. tregon: *“I Dërguari ﷺ doli në vendin e faljes së namazit të Bajramit, në Bajramin e Kurbanit apo të Fitrit. Ai kaloi pranë grave dhe tha: “O ju gra, jepni sadaka, se unë kam parë që shumica e atyre që hyjnë në zjarr ishin gra”. Ato i thanë: “E përse o i Dërguar i Allahut ﷺ?” Ai u tha: “Ngase ju mallkoni*

¹EbuDavud:287, Tirmidhiu:128, Albani-Sahih

²El-Bekare: 222

³Muslimi: 302

⁴Talak:1

⁵Buhariu:5251, Muslimi:1471

⁶Buhariu:320, Muslimi:333

shpesh dhe përbuzni mirësitë e burrit. Nuk kam parë më të mangëta në mendje e në fe, (e në anën tjetër) ndonjëra prej jush t'i marrë mendjen një burri të mençur e të patundur". Ato i thanë: "Cila është mangësia e mendjes dhe e fesë sonë o i Dërguari i Allahut ﷺ?" Ai u tha: "A nuk vlen dëshmia e gruas sa gjysma e dëshmisë së burrit?" "Patjetër, - i thanë ato". "Kjo është mangësia e mendjes së tyre, - tha i Dërguari ﷺ dhe vazhdoi: "E kur është me cikël mujor, a nuk falet dhe nuk agjëron?" "Patjetër, - pohuan ato". "Kjo pra është mangësia e fesë së saj, - u tha i Dërguari ﷺ".¹

5. Tavafi: Siç i ka thënë i Dërguari ﷺ Aishes r.a.: *"Bëji të gjitha që i bëjnë haxhilerët, përveç tavafit rreth Qabes deri sa të pastrohesh."*²

6. Leximi i Kuranit: Kjo është sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, nga sahabët, tabiinët dhe të tjerët pas tyre.

E gjithë kjo, sepse ata e bënë analogji me Xhunubllëkun.

Transmeton Aliu se: *"i Dërguari ﷺ ua mësonte Kuranin dhe nuk i ndante asgjë nga Kurani vetëm se xhunubllëku".³*

Mirëpo, nëse është e nevojshme të lexojë Kuran, sikurse është përsëritja e sureve që i ka mësuar përmendësh që të mos i harrojë, apo si shkak i mësimi të tjerëve në shkollë apo mexhlise, apo leximit të pjesës së caktuar në përditshmërinë e sajë, atëherë i lejohet leximi.

7. Prekja e Mus'hafit: Allahu i Madhëruar thotë:

"لَا يَمَسُّهُ إِلَّا الْمُطَهَّرُونَ" **"Atë nuk e prek kush, vetëm të pastrit"**⁴

E nëse gruaja vesh dorëza apo e kapë atë me ndonjë leckë, atëherë lejohet.

8. Hyrja në xhami dhe qëndrimi në të.

Është çështje për të cilën ka mospajtim mes dijetarëve, por mendimi më i vërtetë është se një gjë e tillë lejohet, me kusht që të mos përlyhet xhamia.

Argument për këtë është hadithi i lartpërmendur ku i Dërguari ﷺ tha: *"Bëj atë që bën haxhiu, përveç tavafit në shtëpinë e shenjtë"*.

¹Buhariu:304

²Buhariu:305, Muslimi:1211, 119

³Tirmidhiu: 146

⁴El-Vakia: 79

Gjithashtu transmeton Aisha r.a. se: “Një grua e quajtur Velidete Seuda r.a. ishte nga një fis arab, të cilët e liruan atë, ndërsa ajo erdh tek i Dërguari ﷺ dhe pranoi islamin. E pastaj banonte në xhami.

Si shkak i ciklit mujor bëhen të obliguara disa gjëra:

1. Gusli: I Dërguari ﷺ në një transmetim thotë: “Lëre namazin në ditët kur je në ciklin mujor, e kur të pastrohesh merr gusul dhe falu.”¹

2. Bylyku: Thotë i Dërguari ﷺ: “Vajzës të cilës i ka ardhur cikli mujor Allahu nuk ia pranon namazin vetëm se me mbulesë”²

Nga ky hadith kuptojmë se i Dërguari ﷺ ia kushtëzoi mbajtjen e shamisë në namaz, që dëshmon se ajo ka arritur moshën e pjekurisë.

3. Me të bëhet llogaritja e kohës së pritjes pas divorcit: Gruaja e cila është në kohën e pritjes, përfundimin e kësaj kohe e llogaritë me cikël mujor.

Allahu i Madhëruar thotë: “وَالْمُطَلَّاتُ يَتَرَبَّصْنَ بِأَنْفُسِهِنَّ ثَلَاثَةَ قُرُوءٍ”

“E ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tre pastrime nga cikli mujor”³

4. Dëshmi se mitra është e pastër dhe nuk është shtatzënë

Vërejtje: Nëse gruaja pastrohet nga cikli mujor apo nga lehonja para perëndimit të diellit, i obligohet të falë namazin e drekës dhe atë të ikindisë, ndërsa ajo e cila pastrohet para hyrjes së kohës së sabahut, obligohet të falë namazin e akshamit dhe atë të jacisë. Është kështu sepse nëse ka arsye koha e namazit të dytë është edhe koha e namazit të parë.

Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, ndër ta edhe: Imam Maliku, Shafiu dhe Ahmedi.

¹Buhariu:306, Muslimi:334

²EbuDavud:641, Tirmidhiu:377, IbnMaxhe:6ç. Albani - Sahih

³El-Bekare: 228

Kohëzgjatja e Lehonisë

- Sa i përket lehonisë ajo nuk ka kohëzgjatje minimale të saj, pasi që nuk ka ndonjë argument të qartë që e kufizon atë. Pra, kohëzgjatja e saj nuk është e caktuar, sado që të zgjasë, po aq llogaritet lehoni, pa marrë parasysh a është pak apo shumë.
- Ndërsa koha më e gjatë e lehonisë është dyzet ditë.

Thotë Tirmidhiu: Të gjithë dijetarët nga sahabet dhe ata që erdhën pas tyre, kanë rënë ujdë se: gruaja lehonë lë namazin dyzet ditë, përveçse në rastet kur ajo pastrohet para të dyzetave. E nëse i përfundon lehonia para të dyzetave ajo pastrohet dhe fillon të falet.

Transmeton Ummu Seleme r.a. e cila thotë: “Gratë lehone në kohën e të Dërguarit ﷺ nuk falnin namaz dyzet ditë”.¹

¹EbuDavud:312, Tirmidhiu:139, IbnMaxhe:648

Istihada (Hemoragjia)

Përkufizimi gjuhësor: *Rrjedhje.*

Përkufizimi terminologjik: *Gjendja kur gruaja ka hemorragji (gjakderdhje nga organi intim) jashtë kohës së cikël mujor dhe të lehonisë.*

Kjo mund të ndodh si shkak i ndonjë sëmundjeje apo anomalie, ndërsa gruaja në këtë gjendje quhet mustehada.

Ky gjak ndryshon nga gjaku i ciklit mujor si në norma ashtu edhe në cilësitë e tij dhe shpërthen nga ndonjë damar i mitrës, dhe mund të ndodh gjatë ciklit mujor apo jashtë saj.

Kjo gjakderdhje nuk ndalon gruan nga falja e namazit, agjërimi, e as kontaktet intime.

Transmeton Aisha r.a. se Fatime bint Ebi Hubejsh r.a. i ka thënë të Dërguarit ﷺ: “O i Dërguari i Allahut! Unë kam istihada dhe nuk po pastrohem (po më vazhdon gjakderdhja edhe pas ciklit mujor), a ta lë namazin? I Dërguari ﷺ tha: Ai është gjak i cili del nga damarët dhe nuk është gjak i ciklit mujor. Kur të vijë koha e ciklit mujor atëherë lëre namazin, e kur të kalojë atëherë pastrohu (merr gusul) dhe falu.¹

Pra është e detyrueshme që gruaja të pastrohet pas përfundimit ciklit mujor, ndërsa gjatë kohës së istihadës (hemorragjisë) pastron organin e saj dhe vendon në të pambuk apo diçka tjetër që të ndalojë gjakderdhjen. Vatrat ditore në kohën e sodit e kryejnë këtë funksion dhe nuk mbet tjetër vetëm se të marrë avdes para faljes së çdo namazi.

Mustehada ka tri gjendje:

Gjendja e parë: Nëse gruaja ka pasur të përmuajshme të caktuara dhe të njohura para istihadës, atëherë ajo vepron e merr në konsideratë periudhën e rregullt të ciklit të saj. Kështu që kohën e ciklit e konsideron cikël, ndërsa kohën tjetër istihada.

Siç i ka thënë i Dërguari ﷺ Ummu Habibes r.a. : “Qëndro aq ditë sa të ka zgjatur zakonisht cikli mujor herëve tjera, pastaj pastrohu dhe falu”.²

¹Buhariu:306, Muslimi: 334 - 65

²Muslimi:334

Gjendja e dytë: Nëse femra nuk ka periudhë të caktuar të ciklit mujor, por gjaku i istihadës dallon nga ai i ciklit mujor.

Shembull: Gjaku i ciklit është më i errët, ka erë, është më i trashë, ndërsa gjaku i istihadës është më i kuq, nuk ka erë, është më i hollë. Në këtë rast gruaja duhet të veprojë sipas cilësive të dalluara të gjakut, dhe si e tillë mund të kuptojë momentin kur ajo është pastruar.

Argument për këtë është fjala e të Dërguarit ﷺ i cili i ka thënë Fatimes bint Ebi Hubejsh r.a. : *“Gjaku i ciklit mujor është i errët. Kur ta shohësh atë mos u fal. E nëse është gjak tjetër, atëherë merr avdes dhe falu, sepse ai del nga damari.”*¹

Gjendja e tretë: Nëse femra nuk e ka të caktuar kohën e ciklit mujor dhe nuk ka mundësi ta dallon gjakun, vepron sipas shumicës së grave. Në këtë rast cikli i saj mujor llogaritet gjashtë apo shtatë ditë për çdo muaj (hënor), duke filluar nga dita e parë që e ka parë gjakun, ndërsa ditët në vazhdim llogariten Istihada. Thotë i Dërguari ﷺ, drejtuar Hamne bint Xhahshit r.a. : *“Vërtetë kjo është përpjekje e shejtanit për të mashtruar. Llogariti gjashtë apo shtatë ditë cikël e pastaj pastrohu, falu dhe agjëro. Kjo të mjafton”*.²

¹ EbuDavud:287, Tirmidhiu:128, Albani - Hasen

² EbuDavud:287, Tirmidhiu:128, Albani - Hasen